



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË

STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

Tema:

**Faktorët etiologjik te krimet kundër jetës dhe trupit të njeriut
në rrethin e Tetovës për periudhën 2010-2015**

Kandidati :

Ambera Musai

Mentori:

Prof.Dr.Besa Arifi

Tetovë, 2019

Përmbajtja

HYRJE	4
KAPITULLI I PARË	6
1. FAKTORËT E KRIMINALITETIT-ETIOLOGJIA KRIMINALE	6
1.1 Kuptimi i faktorëve kriminogjen – etiologjisë kriminale	6
1.2 Faktorët e jashtëm (objektivë) të kriminalitetit	7
1.2.1 Faktorët ekonomiko-shoqërorë.....	7
1.2.2 Faktorët ideopolitikë	10
1.2.3 Faktorët mikrogruporë.....	13
1.2.4 Faktorët socio-patologjikë	15
1.3 Faktorët e brendshëm (subjektivë) të kriminalitetit	18
1.3.1 Baza psiqike e personalitetit	18
1.3.2 Baza biologjike e personalitetit	21
1.3.3 Çrregullimet mentale	21
KAPITULLI I DYTË	22
2. ETIOLOGJIA E KRIMINALITETIT KUNDËR JETËS DHE TRUPIT	22
2.1 Kuptimi për veprat penale kundër jetës dhe trupit	22
2.2 Llojet e veprave penale kundër jetës dhe trupit	23
2.3 Faktorët kriminogjen që ndikojnë te veprat penale kundër jetës dhe trupit	29
KAPITULLI I TRETË	31
3. STUDIMI EMPIRIK MBI FAKTORËT KRIMINOGEN TE VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT	31
3.1 Prezentimi i rezultateve nga hulumtimi i bërë në gjykatën e shkallës së parë në Tetovë	31
3.2 Prezentimi i rezultateve nga intervista me persona kompetent	36
3.3 Studimi i rasteve konkrete	39

KAPITULLI I KATËRT	43
4. PARANDALIMI I KRIMEVE TË DHUNËS	43
PËRFUNDIMI	47
BIBLIOGRAFIA	50

Hyrje

Në këtë tezë të magistraturës do të hulumtohet për etiologjinë kriminale në përgjithësi dhe faktorët kriminogjen, gjithashtu do të hulumtohet mbi krimet kundër jetës dhe trupit të njeriut, dhe do të bazohet në të dhëna për 2 grupe veprash penale si vrasje dhe lëndime trupore, si një ndër faktorët nga kërcënuesit më kryesor të rrezikimit të sigurisë dhe jetës së njeriut, gjithashtu do të analizohen edhe raste të vrasjeve dhe lëndimeve trupore të mara nga gjykata e shkallës së parë në Tetovë.

Për më tepër, do të mundohem të jap një sqarim se çfarë janë veprat penale kundër jetës dhe trupit të njeriut, llojet e këtyre veprave penale, si dhe cilët janë faktorët që ndikojnë në shuarjen e jetës së njeriut si një fenomen kompleks mjaft i përhapur në shoqërinë tonë.

Faktorët kriminogjen janë të gjitha ato shkaqe, dukuri, rrethana dhe kushte që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit dhe sjelljeve kriminale në një vend.

Veprat penale kundër jetës dhe trupit të njeriut janë vepra të rënda të parapara me ligj, sepse ato cënojnë të drejtën themelore dhe më të çmuar të njeriut: të drejtën për të jetuar.

Ky hulumtim ka për qëllim të studiojë se cilët nga faktorët kriminogjen kanë ndikim më të madh në kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit të njeriut, si dhe çfarë metoda janë përdorur dhe me çfarë dënime janë gjykuar personat që kanë kryer këto veprave penale, analiza do të bazohet në disa raste të mara nga gjykata e Tetovës.

Objektivat tjera specifike që duhet përmendur janë edhe këto:

- Për çfarë arsye është kryer vepra penale.
- Çfarë mjete janë përdorur për kryerjen e veprës penale.
- Aktgjykimi dhe aktvendimi i veprës penale.

Në rrethin e shoqërisë ku jetojmë ditët e sodit, kërcënimi kundër jetës së njeriut është një nga format më të shpeshta dhe shqetësuese që shoqëria jonë ka hasur gjatë gjithë kësaj periudhe dhe dukshëm kjo gjë po shkon në rritje. Në këtë hulumtim do të jap një shpjegim dhe analizë të këtij fenomeni shqetësues dhe rrezikues që dita ditës po shkon në rritje numri i veprave penale të rënda kundër jetës dhe trupit të njeriut, dhe sipas mendimit tim modest, këta ndoshta do të jenë edhe disa nga arsyet kryesore që do të risin interesin e kësaj teze.

I. KAPITULLI I PARË

1. FAKTORËT E KRIMINALITETIT-ETIOLOGJIA KRIMINALE

1.1 Kuptimi i faktorëve kriminogjen – etiologjisë kriminale

Etiologjia kriminale ka të bëjë me njohjen e burimeve dhe rethanave të cilat çojnë në paraqitjen e kriminalitetit. Faktorët kriminogjen janë të gjitha ato shkaqe, rrethana, dukuri apo kushte që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit dhe sjelljeve tjera antisociale dhe negative në një shoqëri. Pra ato janë rrethana të natyrës objektive dhe subjektive që shpjegojnë lidhjet me kriminalitetin.

Vetë fjala etiologji do të thotë shkencë mbi thelbin dhe shkaqet e një dukurie, pra etiologjia kriminale meret me shpjegimin e proceseve të ndryshme në shoqëri të cilat shpien deri te sjelljet kriminale. Fenomeni kriminal është përshkrim i mënyrës së kryerjes së krimeve, pra është shkencë mbi manifestimin e kriminit.

Faktorët kriminogjen në kuptimin më të gjërë të fjalës paraqesin të gjithë faktorët që ndikojnë në formësimin dhe realizimin e sjelljeve të cilat janë të ndëshkueshme me ligj si dukuri shoqërore dhe individuale.

Ekzistojnë teori të ndryshme mbi të cilat bazohen faktorët kriminogjen disa prej tyre shkaqet e kriminalitetit i gjejnë vetëm te një faktor pra tek individi, dhe disa të tjera theksojnë se shkaqet e kriminalitetit paraqiten nga më shumë faktorë, siç janë rrethanat familjare, ekonomike, shoqërore etj.

Faktorët kriminogjen të cilët kontribuojnë në kriminalitet në përgjithësi ndahen në: Faktorë të jashtëm objektiv apo ekzogjen dhe faktorë të brendshëm subjektiv apo endogjenë.

1.2 Faktorët e jashtëm (objektivë) të kriminalitetit

Sipas mendimit të disa kriminologëve, ndikim më të madh në paraqitjen e kriminalitetit kanë faktorët e jashtëm kriminogjenë, faktorët e jashtëm apo ekzogjen paraqesin kushte dhe rrethana determinuese të sjelljes kriminale. Ata ndikojnë drejtpërsëdrejti në paraqitjen e aktiviteteve kriminale në shoqëri.¹ Këtu bëjnë pjesë: grupi i faktorëve ekonomiko-shoqërorë, faktorët ideopolitikë, faktorët mikrogruporë, faktorët sociopatologjikë etj.

1.2.1 Faktorët ekonomiko-shoqërorë

Zhvillimi i hovshëm industrial, të arriturat e mëdha teknike, zhvillimi i elektronikës dhe një varg transformimesh të mëdha që janë bërë në shoqëri, kanë ndikuar edhe në proceset e formimit të njeriut dhe personalitetit të tij, këto të arritura dhe transformime të mëdha në një anë kanë kontribuar në krijimin e një mirëqenie dhe standardi të lartë, në anën tjetër, me miliona njerëz vuajnë nga urria, skamja, papunësia dhe sëmundjet e ndryshme. Të gjitha këto kanë ndikim të caktuar në veprimet dhe sjelljet kriminale.

Nga këto faktorë që kanë ndikim të madh në paraqitjen e sjelljeve kriminale janë:

- Industrializimi dhe urbanizimi
- Migrimi i njerëzve, dhe kriminaliteti i të huajve
- Krizat dhe depresionet ekonomike
- Varfëria
- Papunësia
- Kushtet e vështira të banimit
- Profesionit²

¹ Hans V.Hentig, Crime causes and conditions, 1959, fq.259-263

² Ragip Halili, Kriminologjia, fq 241-242, Prishtinë 2011

Industrializimi dhe urbanizimi- Industrializimi është një proces i progresit ekonomik e material, kjo me vete sjell edhe rritjen e popullatës urbane, zgjerimin e qyteteve etj, këto ndryshime ndikojnë që vendet rurale-fshatare të kthehen në vende urbane dhe nga vende të vogla dhe të varfëra të bëhen zona të zhvilluara dhe metropole botërore, disa shtete nga industrializimi kanë arritur standarde të larta dhe kanë përparuar, mirëpo për fat të keq në disa vende industrializimi ka pasur edhe efekte negative dhe meret si faktor kriminogjen pasi që në këto vende për shkak të numrit të madh të migrimit të popullsisë, janë hasur probleme me banimin, arsimimin, punësimin etj, gjithë këto mungesa kanë rritur papunësinë në vend janë shtuar personat e varfër po ashtu është paraqitur edhe dukuria e alkoolizmit, narkomanisë, prostitucionit dhe kështu ka ardhur deri tek paraqitja e sjelljeve kriminale dhe dukurive tjera negative.

Migrimi i njerëzve- Prania e personave të huaj në shumë vende paraqet probleme dhe për shkak të shtimit të popullsisë vendet bëhen më dinamike dhe shtohen sjelljet kriminale. Emigrantët zakonisht lëvizin nga vende rurale në vende urbane dhe si qëllim kanë që të krijojnë një të ardhme më të mirë sociale, ekonomike dhe kulturore, pra thënë më shkurt një jetë më të mirë dhe më cilësorë, mirëpo struktura e qytetit ku ata fillojnë të banojnë është e ndryshme nga vendi prej nga kanë ardhur dhe gjatë ambientimit të tyre ato përballen me pengesa lidhur me arsimimin, punësimin ata nuk mund të përshtaten me jetën e qytetit rregullat etj, dhe kështu në një farë mënyre për të siguruar kushte për jetesë fillojnë meren me sjellje kriminale.

Krizat dhe depresionet ekonomike- Konsiderohen si faktor me ndikim të madh në paraqitjen e sjelljeve kriminale, ndryshimet e mëdha politike, prishin balancat në shoqëri dhe ekonomi dhe krijojnë kriza në të gjitha institucionet sociale, këto kriza vështirsojnë ekzistencën e popullsisë pasi që vjen deri tek ngritja e çmimeve, shtrejtimi i të mirave materiale etj. Njerëzit fillojnë të hasin probleme me punësimin dhe kështu krijohen stresa, pasiguri, varfëri, dhunë, armiqësi politike dhe si pasojë vjen deri tek paraqitja e sjelljeve kriminale.

Varfëria- Gjithashtu është një faktor që ka ndikim të madh në paraqitjen e kriminalitetit. Sipas disa autorëve ekziston mendimi që thonë se “varfëria është nëna e krimit”. Varfëria dhe skamja vijnë si pasojë e krizave ekonomike nga mosfunksionimi i ekonomisë dhe kushtet e rënda materiale, e gjithë kjo shpie deri tek ajo që personat të fillojnë të merren me sjellje kriminale, zakonisht veprimet kriminale që kryhen nga varfëria dhe skamja janë krime të vogla si vjedhe të imëta, mashtrime, bredhje, prostitucion etj. Edhe pse thuhet që pjesa e varfër e popullsisë përbën burimin kryesor të popullatës kriminale mirëpo kriminaliteti në përgjithësi nuk është vetëm rezultat i varfërisë dhe skamjes por shpesh është edhe rezultat i rrethanave dhe kushteve tjera.

Papunësia- Është e ngjashme me varfërinë, të dyja këto dukuri janë në nivele shqetësuese pasi që dita ditës po shkojnë në rritje, edhe papunësia vjen në shprehje gjatë krizave dhe depresioneve ekonomike dhe nga këto situata paraqitet pamundësia e sigurimit të mjeteve për ekzistencë, pamundësia e shkollimit e sigurimit shëndetësor dhe kjo ndikon që individët nga ata të mitur e deri në ato profesionist rrugën e krimit ta shohin edhe si mënyrë jetese. Edhe një thënje popullore që përdoret në shoqëri thotë se “Papunësia është nëna e të gjitha të këqijave”. Pra papunësia dhe varfëria në vend ndikojnë dukshëm në rritjen agresive të fenomenit kriminal.

Kushtet e vështira të banimit- Problemi i banimit është i lidhur me procesin e migrimit, për shkak të ardhjes së personave të ri në qendra të zhvilluara e industriale vendi mbipopullohet dhe kështu hasen probleme me banimin, vështirsohet mundësia e gjetjes së vendeve për strehim si banesa apo shtëpi. Për shkak të problemit që hasin me banimin shpesh familjet me më shumë anëtarë vendosen nëpër objekte më të vogla ku nuk kanë kushte elementare për të jetuar dhe kështu tek të rrinjtë për shkak të pamundësisë për të plotësuar kërkesat e tyre dhe nevojat nxitet ikja, largimi në rrugë kriminale etj.

Profesioni- Gjithashtu konsiderohet si një nga faktorët i cili ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Për dallim nga rastet tjera kur kriminaliteti paraqitet si pasojë e varfërisë, e papunësisë, e migrimëve etj, kriminaliteti sipas profesionit ka të bëjë me aftësinë e disa personave të cilët e keqpërdorin vendin e punës, detyrën zyrtare dhe njohurit e tyre profesionale për të kryer vepra penale, personat të cilët më shpesh paraqiten si kryes të veprimeve kriminale duke shfrytëzuar vendin e punës janë: personat që punojnë si kontabilistë, mjekët, furnizuesit etj, ato zakonisht bëjnë mashtrime, falsifikime dhe asgjësime të dokumenteve, dhe punë të ndryshme antiligjore, pra kryejnë akte kriminale. Këto praktika i kanë njëllosur aftësitë

profesionale e intelektuale, i bëjnë njerëzit pesimistë, dhe gjallërojnë korrupsionin, pra gjitha këto përbejnë një tërësi faktor madhor në kriminalitet.

1.2.2 Faktorët ideopolitikë

Faktorët ideopolitike përfshijnë një numër të madh të shkaqeve dhe rrethanave, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe indirekte ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit në shoqëri. Këto rrethana kanë të bëjnë me konfliktet e ndryshme ideore e politike, me konfliktet kulturore, me praninë e ndikimit të mjeteve të komunikimit masovik etj. Pra realiteti dëshmon se një numër i madh i sjelljeve kriminale është pasojë e drejtpërdrejtë e ndikimit të këtyre rrethanave.

Si faktorë të këtillë që kanë ndikim në paraqitjen e sjelljeve kriminale konsiderohen:

- Konfliktet politike
- Konfliktet kulturore
- Lufta
- Arsimimi
- Mjetet e komunikimit
- Religjioni dhe sektet ekstreme ³

³ <https://www.slideshare.net/dritashala/kriminologjia-18679197>

Konfliktet politike- Janë faktorë që kanë ndikim të madh në paraqitjen e sjelljeve kriminale në shoqëri. Konfliktet politike rrisin ndjeshëm tensionet mes popullatës, tensionet etnike, bëjnë përçarje të popullatës, rrezikojnë standardet demokratike, rritet dhuna politike dhe shtohen aktivitete kriminale që çenojnë liritë dhe të drejtat e njeriut. Përmbysjet e mëdha politike sjellin periudha të vështira në shoqëri, çregullojnë familjet dhe individët në tërësi. Këto veshtërsi shoqërohen me shkatërrime, me trafikim të armëve, me prodhim të lëndëve narkotike dhe kjo gjendje krijon stresse, varfëri, emigrim, dhunë, armiqësi politike, e cila ka për pasojë paraqitjen e sjelljeve kriminale.

Konfliktet kulturore- Zakonisht paraqiten tek shtetet multietnike të cilat kanë strukturë multikulturore, pasi që shoqëria në këto shtete përbëhet nga popuj të ndryshëm të religjioneve dhe racave të ndryshme, të cilët i aplikojnë rregullat zakonet dhe doket e veta dhe mundohen që ato rregulla t'ia imponojnë njëri tjetrit dhe kështu vin deri tek mosmarveshjet në mes grupeve paraqitet urrejtja dhe nxiten sjelljet kriminale. Këto konflikte kulturore gjithashtu vërehen edhe gjatë migrameve të qytetarëve të cilët levizin nga zona rurale në vende urbane dhe të zhvilluara.

Lufta- Në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Gjatë konflikteve luftarake veprimet e kriminalitetit janë dukshëm në rritje, pasi që kryhen vrasje makabre, gjenocid, dhunime, tortura, vjedhje dhe shumë vepra tjera të kundërligjshme. Kriminaliteti është shumë i përhapur edhe pas luftës pasi që nga pasojat që ka sjellur lufta janë shkatëruar objekte të ndryshme si shtëpi, banesa, shkolla etj, shumë fëmijë ngelin pa prindër, gjithashtu shume njerëz ngelin invalid dhe të paaftë për të punuar, dhe kështu nga skamja, varfëria dhe papunësia individët për shkak të pamundësisë për të siguruar kushtet për jetesë fillojnë të meren me sjellje kriminale.

Arsimimi- Është një faktor i cili ka rëndësi të madhe në formimin e personalitetit të njeriut, për mënyrën e jetesës së tij. Në një shoqëri të arsimuar dhe të kulturuar kriminaliteti mund të zvogëlohet pasi që personat e arsimuar janë të edukuar, të paisur me dije, nuk kanë vese të këqija dhe sjellja e tyre zakonisht është në pajtim me ligjin. Janë të rrallë personat e arsimuar të cilët kryejnë vepra penale pasi që arsimimi e senzibilizon njeriun, ato janë të vetëdijshëm për pasojat që mund të sjell kryerja e veprës penale dhe prandaj qëndrojnë larg këtyre veprimeve. Mirëpo ka edhe disa raste ku arsimimi mund ti aftësojë personat të cilët janë të prirur për kriminalitet pasi që me ndihmën e njohurive që posedojnë dhe profesionit ata i kryejnë veprat penale më lehtë dhe

me më pak vështirësi. Në shumë vende të botës veprat penale kryhen nga persona me shkallë të ulët të arsimimit dhe analfabetë, mirëpo ka raste ku këto vepra kryhen edhe nga persona të arsimuar dhe të edukuar, prandaj ky faktor mund të ketë edhe ndikim pozitiv edhe negative në paraqitjen e sjelljeve kriminale.

Mjetet e komunikimit- Luajnë rol të rëndësishëm në paraqitjen e sjelljeve kriminale në shoqëri e sidomos tek të miturit. Si mjete të komunikimit konsiderohen: shtypi, literatura, televizioni, filmi etj. Të cilët me informatat e tyre e orientojnë publikun në kahje të ndryshme. Ka raste ku në mjete të informimit paraqiten emisione të cilat kanë përmbajtje edukative, kulturore e arsimore dhe gjitha këto mund të ndikojnë pozitivisht në formimin dhe zhvillimin e personalitetit të të miturit. Mirëpo ka raste ku te këto mjete të informimit si p.sh. në televizion jepen programe apo filma të cilat kanë përmbajtje kriminale dhe në to përshkruhen në mënyrë të hollësishme veprat penale: si, pse dhe me çfarë mjete janë kryer, gjithashtu jepen edhe programe me përmbajtje të dyshymta morale, dhunuese. Të miturit mund të hasin dhe të lexojnë edhe ndonjë libër me përmbajtje kriminale apo jo të përshtatshme, pra gjitha këto mund të ndikojnë negativisht tek individët e sidomos tek të miturit, pasi që ata nuk janë në gjendje që të bëjnë analiza të atyre veprimeve që paraqiten ne televizion, apo që i lexojnë dhe kështu i nxisin dhe shtytin ato në veprime kriminale.

Religjioni dhe sektet ekstreme- Religjioni si pjesë e natyrës së njeriut ka ndikim të madh në sjelljet dhe veprimet e individëve. Religjioni ka të bëjë me atë se çfarë feje ka zgjedhur individi për të besuar. Ka raste ku personat që janë fetar nuk kryejnë vepra penale për shkak të besimit të tyre, sepse gati në të gjitha librat e shenjtë thuhet që besimtarët mos të kryejnë veprime negative dhe të ndaluar si p.sh: mos të vjedhin, mos të vrasin, te duan të afërmit, të ndihmojnë te varfërit etj. Mirëpo ka raste ku në disa vende për shkak të konflikteve religjioze mes popullatës paraqiten sjellje kriminale.

1.2.3 Faktorët mikrogruporë

Disa bashkësi shoqërore kanë ndikim të madh në formimin dhe zhvillimin e personalitetit të njeriut që nga fëmijëria e hershme e deri në moshën e shtyrë. Këta faktorë kanë të bëjnë me disa institucione shoqërore në të cilat njeriu e kalon pjesën më të madhe të jetës së vet. Si bashkësi të tilla shoqërore konsiderohen: familja, shkolla, lagja, mjedisi shoqëror, ambienti social etj. Të gjitha këto bashkësi ndikojnë dhe lënë gjurmë të thella në secilin individ. Në pjesën më të madhe këto institucione kanë ndikim pozitiv dhe afirmativ në jetën e njeriut. Mirëpo te një numër i madh i delikuentëve këto institucione shpeshherë kanë lënë ndikime negative. Si shkak i drejtpërdrejtë i marjes me veprime kriminale të disa personave janë sjelljet negative, traumat, konfliktet, përjetimet tragjike dhe të pakëndshme që ata i kanë pasur në këto ambiente.

Nga faktorët mikrogrupor që kanë ndikim në paraqitjen e sjelljeve kriminale janë:

- Familja
- Ambienti shkollor
- Mjedisi social ⁴

Familja- Konsiderohet si një ndër grupet primare ku realizohet procesi i edukimit zhvillimit, formimit dhe socializimit të personlitetit të njeriut e sidomos te fëmijët. Familja është kontakti i parë që e ka fëmija prej ardhjes së tij në këtë botë, prej nga edhe i mëson pikëpamjet e para për jetën, familja si institucion shoqëror ka rol të madh në përgaditjen për jetë të fëmijës, pra ajo ka shumë funksione të rëndësishme për formimin e karakterit të fëmijës në përgjithësi, prindërit janë udhëheqës në familje dhe varësisht se si do ti kryejnë ato funksione ashtu do të rritet edhe antari i ri i familjes. Familja ka rëndësi themelore në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, mirëpo në qoftëse familja këto funksione që janë bazë për jetën nuk i kryen në mënyrë të drejtë dhe ashtu siç duhet, atëher ajo mund të bëhet edhe faktor me ndikim negativ në paraqitjen e sjelljeve kriminale, ku fëmijët dalëngadalë fillojnë të meren me sjellje devijante.

⁴ Ragip Halili, Kriminologjia, fq 275, Prishtinë 2011

Këto raste zakonisht ndodhin tek familjet e degraduara për shkak të problemeve që hasen në familje dhe shkatërimeve të tyre, familjet e mangëta mund të kenë ndikim negative tek fëmijët dhe të nxisin sjelljet kriminale për shkak të mungesës së njërit prind apo edhe të dyve, gjithashtu ndikim në nxitjen e sjelljeve kriminale tek fëmijët ka edhe raporti mes prindërve dhe fëmijës, mënyra se si ata komunikojnë mes veti etj.

Ambienti shkollor- Gjithashtu është një faktor me rëndësi të madhe në zhvillimin, aftësimin dhe edukimin e individit pas familjes. Ambienti shkollor u mundëson fëmijëve që të mësohen si të sillen në familje dhe në shoqëri, ato në shkollë fitojnë dituri, përparojnë me njohuritë e arritjeve shkencore e kulturore etj. Arsimimi ka rëndësi të madhe në zhdukjen e sjelljeve negative në shoqëri, mirëpo ka raste kur edhe në shkollë paraqiten probleme që ndikojnë në menyrë negative të sjelljet e fëmijëve dhe konsiderohen si faktor kriminogjen. Në shumë vende të botës, sidomos në ato të pazhvilluara nëpër shkolla programet e arsimimit nuk i kanë në nivel të duhur, kanë mungesa të mjeteve dhe gjithë këto ndikojnë që të bie niveli i arsimimit dhe edukimit në tërësi dhe kështu nxënësit fillojnë të braktisin orët mësimore dhe kthehen kah veprimet dhe sjelljet delikvente.

Mjedisi social- Edhe mjedisi social është një faktor që ka ndikim në personalitetin e njeriut, pasi që një kohë të gjatë të jetës personi e kalon në mjedis shoqëror. Mjedisi social mund të konsiderohet si faktorët i cili ka ndikim më të madh në paraqitjen e sjelljeve kriminale se sa familja dhe shkolla. Sepse gjatë qëndrimit me shoqëri nëpër lagje fëmijët mund të hasin me grupe të ndryshme apo banda që meren me veprime kriminale, këto grupe shpesh mundohen që edhe të miturit të orientojnë kah këto rrugë, dhe kështu të imponuar edhe fëmijët mund të fillojnë të meren me ato vese, të mësojnë ato rrugë të këqija devijante dhe të fillojnë të meren me aktivitete kriminale.

1.2.4 Faktorët socio-patologjikë

Këto faktorë quhen socio-patologjikë për arsye se kanë të bëjnë me një sëmundje shoqërore e cila kaplon raportet e caktuara në një rafsh më të gjërë. Këto dukuri kanë të bëjnë me cënimet e disa vlerave morale, njerzore e shoqërore, të cilat kontribuojnë në paraqitjen e sjeljeve delikente në një vend që janë të lidhura me çregullimet e mëdha ekonomike, politike e kulturore.

Si dukuri socio-patologjike që kanë ndikim në paraqitjen e kriminalitetit konsiderohen:

- Prostitucioni
- Patologjia seksuale
- Alkoolizmi
- Narkomania
- Bixhozi
- Hakmarrja dhe gjakmarrja ⁵

Prostitucioni- Është faktor sociopatologjik i cili konsiderohet si vepër kundër moralit dhe dinjitetit. Prostitucioni është dukuri negative shoqërore që nënkupton marrëdhëniet intime seksuale në formë të zanatit me qëllim të përfitimit, ai paraqet sjellje devijante në shoqëri dhe është i dëmshëm, nga prostitucioni mund të rrjedhin edhe shumë sjellje të tjera kriminale siç janë: vrasjet, plaçkitjet, vjedhjet, mashtrimet e sidomos shitblerja e drogave është mjaft e përhapur në prostitucion. Prandaj mund të thuhet se për dallim nga faktorët tjerë prostitucioni apo faktorët socio-patologjik kanë lidhje të drejtpërdrejta me kriminalitetin.

⁵ Ragip Halili, Kriminologjia, fq 288, Prishtinë 2011

Patologjia seksuale- Nënkupton devijimet dhe çrregullimet e ndryshme seksuale në lidhje me jetën seksuale të cilat paraqiten te personat e caktuar, këto çrregullime mund të jenë nga më të ndryshmet dhe mund të paraqiten edhe te femrat edhe te meshkujt, dhe gjitashtu kanë ndikim të madh në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Si forma të patologjisë seksuale mund të përmenden edhe: pedofilia, zoofilia etj.

Alkoolizmi- Është një ndër faktorët sociopatologjik i cili është mjaft i përhapur në botën e sodit. Alkoolizmi si faktor është dukuri e varshmërisë nga alkooli që vjen nga konsumimi i tepërt i pijeve alkoolike. Tek personat të cilët janë të varur nga alkooli paraqitet dëmtim i shëndetit fizik, psiqik dhe social, këta persona për shkak të varshmërisë nga alkooli mund të bëhen pjesë e veprimeve devijante, pasi që nga konsumimi në mënyrë të rregullt mund të humbin vetëdijen, gjithashtu kanë çrregullime të marrëdhënieve me personat tjerë, u zvogëlohet edhe ndjenja e përgjegjësisë dhe botës reale dhe kështu për shkak të pandjesisë mund të kryejnë edhe vepra penale.

Narkomania- Paraqet një faktor kriminogjen dhe shumë negativ në shoqëri e cila ka të bëjë me përdorimin e drogave dehëse dhe substancave tjera narkotike. Kjo dukuri ka kapluar një pjesë të madhe të botës dhe dita ditës po shkon në rritje që do të thotë se është një problem global. Përdorimi i këtyre substancave ndikon tek shëndeti, puna, jeta personale, familja dhe në rrethin shoqëror sepse janë të dëmshme. Disa lloje të pijeve narkotike janë: marihuana, kokaina, kanabisi, hashishi etj. Personat të cilët konsumojnë këto pije narkotike në mënyrë të rregullt, shpesh meren me veprime kriminale dhe sjellje tjera të rrezikshme, më së tepërmi ato meren me shpërndarjen e drogave, tregti me armë, prostitucion, vjedhje etj.

Bixhozi- Është lojë fati e cila është e rrezikshme për shoqërinë, dhe në botën bashkëkohore është shumë e përhapur dhe dita ditës po shkon në rritje. Këto lojra quhen të fatit sepse nuk dihet se kush do të fitojë dhe çka do të ndodh më tutje. Individët meren me bixhoz dhe bëhen të varur sepse duket si një dukuri me pak angazhime e me shumë fitim dhe më pas kalon në semundje dhe paraqiten probleme familjare e sociale. Bixhozi si lojë fati është e lidhur ngusht edhe me sjelljet tjera kriminale si: narkomaninë, prostitucionin, korrupsionin, kidnapimin etj. Dukuri këto që sot kanë kapluar një pjesë të madhe të botës dhe të njëjtat janë prezente edhe në Maqedoni.

Hakmarrja dhe gjakmarrja- hakmarrja dhe gjakmarrja janë dukuri sociopatologjike që sjellin pasoja shoqërore për familjet dhe shoqërinë në përgjithësi, ky fenomen ka qenë prezent qysh në kohërat e lashta dhe fatkeqësisht edhe sot vazhdon të jetë prezent në disa vende e sidomos në ato ku jetojnë shqiptarë. Hakmarrja dhe gjakmarrja mund të konsiderohen si dukuri shumë të këqija të cilat sjellin vetëm trishtim, pasi që vrasjet nga këto dukuri janë zinxhir që përcillen brez pas brezi në familjet që janë në hasmëri deri sa të shuhen të dy fiset. Fenomeni i hakmarjes, gjakmarrjes mbetet tepër shqetësues për gjithë shoqërinë e sidomos në ato vende ku nuk funksionon drejtësia dhe autoriteti i shtetit, sepse sa më i dobët të jetë autoriteti i ligjit, aq më tepër shtohen krimet, sidomos hakmarrja. Fatkeqësisht kemi shumë raste që mund të meren si shembujt në familjet shqiptare ku janë kryer vepra penale të vrasjes për shkak të hakmarjes.

1.3 Faktorët e brendshëm (subjektivë) të kriminalitetit

Faktorët e brendshëm subjektiv kanë të bëjnë me personalitetin e kryesit-individin. Këtu theksohet roli dhe rëndësia e jetës së tij biopsiqike dhe lidhjet e saj me sjelljet dhe veprimet kriminale. Thuhet se ndikimet e faktorëve të jashtëm në sjelljet dhe veprimet e personalitetit varen shumë nga vetë struktura biologjike dhe psiqike e atij individi. Nëse ajo strukturë është normale dhe nuk ka defekte apo anomali atëherë personaliteti i njeriut është më rezistent ndaj ngacmimeve dhe ndikimeve që vijnë nga jashtë, dhe anasjelltas. Te faktorët e brendshëm apo subjektiv bëjnë pjesë: baza psiqike, baza biologjike dhe çrregullimet mentale.

1.3.1 Baza psiqike e personalitetit

Personaliteti i njeriut është i ndërtuar në bazë psiqike dhe biologjike, që janë dy kompetente me rëndësi për zhvillimin dhe formimin e tij si personalitet normal. Baza psiqike ka ndikim dhe reflektohet në sjelljet dhe veprimet e personalitetit të njeriut, varësisht se si është zhvilluar personaliteti gjatë jetës së tij. Bota e tij e brendshme, bota psiqike ka rëndësi të veçantë në shpjegimin e sjelljeve kriminale. Si veti psiqike që e pasqyrojnë personalitetin e një individi janë: karakteri, tempermenti, shprehitë, iteligjenca, emocionet, motivet etj.⁶

Karakteri- Me karakter nënkuptojmë veçoritë e personalitetit të individit që e dallojnë në njeri nga njerëzit e tjerë. Karakteri apo personaliteti i njeriut formohet si rezultat i jetës që bën njeriu në shoqëri. Tiparet e personalitetit zhvillohen gjatë socializimit të njeriut ku rol të veçante luajnë grupi shoqëror ku ai jeton si: familja, shkolla, ambienti social etj, pra nga këto burime ai formon një qëndrim të vetin ndaj ambientit shoqëror. Ekzistojnë persona me karakter pozitiv apo negativ, ose me karakter stabil apo labil. Si veti të karakterit mund të përmendim edhe: vetëbesimin, ndershmërinë, guximin, sinqeritetin, agresivitetin etj. Varësisht se çfarë karakteri ka formuar individi gjatë jetës së tij ashtu dhe do të sillët në shoqëri. Personat delikuent apo kriminel zakonisht janë personat të cilët nuk i kanë virtytet pozitive të karakterit por kanë veti negative në sjelljet e tyre.

⁶ Ragip Halili, Kriminologjia, fq 339-340, Prishtinë 2011

Temperamenti- Është tërësia e vetive psikike të një personi, që janë të lidhura me përjetimet e tij, dhe dalin në pah me reagimin e tij ndaj ngacmimeve të jashtme. Sipas temperamentit përcaktohet edhe sjellja e njeriut në shoqëri. Ekzistojnë disa klasifikime të tipave të temperamentit, por sipas filozofit të njohur grek Hipokratit dallohen 4 tipe të temperamentit.⁷

1. Temperamenti kolerik: personat me temperament kolerik janë plot agresion dhe energji, marrin vendimet shpejt dhe nervozohen menjëherë për gjëra të vogla, po ashtu këta persona janë të pandjeshëm dhe nuk janë sa duhet stabil, gjithë këto veti ndikojnë që te këta persona të paraqiten sjelljet negative dhe veprimet kriminale. 2. Temperamenti sanguinik: këta persona janë tipa gjaknxehtë, reagojnë shpejt ndaj ngacmimeve të jashtme, gjithashtu janë persona entuziast dhe shumë lehtë ndërojnë disponimin, për këtë arsye këta persona mund të kryejnë vepra penale në çast. 3. Temperamenti flegmatik: nga vetë fjala kuptohet se këto persona janë tipa të qetë, të urtë, tolerant, i marrin gjërat më ngadalë dhe rallë shqetësohen. Për shkak të kësaj natyre që e posedojnë këta persona më shumë mund të paraqiten si viktimat të veprave penale se sa si kryes. 4. Temperamenti melankolik: këta persona janë tipa të ndjeshëm, shumë lehtë preken dhe ndiejnë thellë, gjithashtu mendojnë shumë. Këta persona zakonisht mund të kryejnë vepra penale të rënda për shkak të emocioneve të fuqishme, dhe janë të prirur për vetëvrasje.

Shprehitë- Janë veti të cilat individi i fiton gjatë jetës së tij, ato mund të krijohen dhe të ndryshojnë nga ambienti social në të cilin jeton ai. Shprehitë mund të jenë pozitive dhe negative. Nëse në rrethin ku formohet dhe edukohet ndividi janë më të shpeshta veprimet antisociale si në familje apo shkollë, atëherë vetvetiu mund të vijë deri te fromimi i shprehive negative siç janë: konsumimi i drogave, alkoolit, vozitja e shpejtë, deliktet seksuale, mashtrimi, kokëfortësia, thashethemet dhe shumë të tjera, të cilat nxisin paraqitjen e sjelljeve kriminale, dhe kështu personat fillojnë të kryejnë vepra penale nga shprehitë.

⁷ <https://vavav.ru/sq/mental-development/psychology-is-the-temperament-of-a-persons-character-what-is-temperament/>

Inteligjenca- është veçori e personalitetit të njeriut e cila luan rol të rëndësishëm në paraqitjen dhe sjelljen e tij në shoqëri. Pra inteligjenca konsiderohet si një aftësi për të kuptuar botën ku jetojmë. Ekzistojnë persona më shumë inteligjent dhe më pak inteligjent. Suksesi në jetë: në punë apo në familje i çdo individ varet nga niveli i inteligjencës. Shkalla e inteligjencës ka lidhje të ngushtë me kriminalitetin, veprat penale më të zakonshme siç janë vjedhjet, plaçkitjet, veprat penale kundër jetës dhe trupit zakonisht kryhen nga personat me shkallë të inteligjencës më të ulët, mirëpo veprat penale si kriminaliteti i ‘jakës së bardhe’, krimi i organizuar etj, zakonisht kryhen nga persona me nivel më të lartë të inteligjencës sepse këta persona falë inteligjencës kanë aftësi që këto krimë ti kryejnë me precizitet.

Emocionet- në strukturën e personalitetit të njeriut ndikim të madh kanë edhe emocionet, ato burojnë nga gjendja shpirtore psiqike e individit, dhe nga përjetimet e tij. Këto emocione mund të jenë: dashuri, gëzim, frikë, hidhërim etj. Personat të cilët kanë çregullime emocionale më shpesh dhe më lehtë mund të kryejnë vepra penale pasi që ato mund ti kapë ndonjë ndjenjë e hidhërimit apo xhelozisë dhe kështu nga emocionimi momental nxiten në kryerjen e veprimeve delikvente.

Motivet- gjithashtu janë veçori të personalitetit të njeriut, motivet kuptohen si nxitje apo shtytje e veprimeve të caktuara që i japin drejtim apo kahje aktivitetit të individit. Ekzistojnë motive nga më të ndryshmet siç janë motivet biologjike, sociale etj. Njerëzit gjatë jetës së tyre kanë dëshira apo nevoja të cilat duan ti plotësojnë, disa njerëz kur këta dëshira për shkak të disa pengesave nuk mund ti realizojnë, atëher tek ata paraqiten situata të veçanta psiqike si zhgënjim, hidhërim, stres, dhe trauma të ndryshme të cilat konsiderohen si motive që i shtynë dhe i nxisin të meren me sjellje kriminale.

1.3.2 Baza biologjike e personalitetit

Baza biologjike është një faktor i cili ka ndikim në paraqitjen e sjelljeve kriminale, personaliteti nuk është një veti e lindur apo e trashëguar, por ai formohet nga një rrugë e gjatë dhe është i lidhur ngushtë me faktorët biologjik. Sipas disa autorëve mendohet se sjellja dhe marja me veprime kriminale e disa personave buron nga vetitë biologjike të njeriut, sipas tyre personat delikuent dallohen nga pamja e tyre fizike, pra ata kanë dukje të veçanta anatomike. Defektet biologjike dhe fizike shpesh her mund të ndikojnë në zhvillimin dhe formimin më të ngadalshëm të personalitetit, kjo natyrisht që luan rol edhe në paraqitjet dhe sjelljet e individit, pasi që personi për shkak të defekteve biologjike që i zoton mund të fitojë dhe disa tipare të personalitetit siç janë: agresiviteti, ndjenja e pasigurisë, zilia etj, të cilat nxisin dhe drejtojnë atë kah sjelljet devijante dhe kriminale.

1.3.3 Çrregullimet mentale

Janë faktor që mund të kenë ndikim në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Me çrregullime mentale nënkuptojmë personat që janë të sëmurë në pikpamje shpirtërore dhe mendore, pra janë persona emociaonalisht jo stabil. Nuk ekziston një rregull se këta persona janë kriminel, sepse ka shumë njerëz që meren me veprime kriminale por nuk vuajnë nga sëmundje mendore, mirëpo ka raste kur edhe personat me çrregullime mentale merren me sjellje kriminale, në qoftëse këta persona kryejnë një vepër penale atë mund ta bëjnë në mënyrë të pa vetëdijshme, sepse këta persona nuk janë në gjendje të mendojnë dhe të gjykojnë për dënimet që sjell kriminaliteti. Në literatuën kriminologjike përmenden disa çrregullime mentale që shpesh kanë lidhje me shumë veprime kriminale siç janë: neurozat, psikozat, psikopatitë. Personat me këto sëmundje në rast të kryerjes së veprave penale janë të përgjegjshëm penalisht, mirëpo në raste të caktuara përgjegjësia e tyre mund të jetë e zvogëluar për shkak të sëmundjes që e vuajnë.

II. KAPITULLI I DYTË

2. ETIOLOGJIA E KRIMINALITETIT KUNDËR JETËS DHE TRUPIT

2.1 Kuptimi për veprat penale kundër jetës dhe trupit

Vepra penale është një akt i sjelljes së njeriut përmes të cilit shkilet kodi penal, i cili akt ka për pasojë dënimin.

Veprat penale janë një fenomen global mjaft shqetësues pasi që dita ditës numri i tyre shkon në rritje, dhe kjo paraqet rrezik të madh për shoqërinë në përgjithësi.

Veprat penale kundër jetës dhe trupit janë vepra të rënda penale sepse ato nënkuptojnë një lloj kërcënimi dhe cënojnë të drejtën dhe lirinë për të jetuar të njeriut, e cila është një e drejtë e garantuar me kushtetutë dhe e drejtë themelore e secilit individ që ekziston në ruzullin tokësor. Me këto vepra nënkuptojmë veprat penale të kryera me dashje ose nga pakujdesia me të cilat personi privohet nga jeta apo i shkaktohet lëndim trupor. Me vepra penale kundër jetës dhe trupit si dukuri negative rrezikohen, dëmtohen, atakohen dhe asgjësohen vlerat individuale siç janë: (jeta e njeriut, liria, shëndeti, nderi e dinjiteti) por edhe ato shoqërore. Prandaj mbrojtja e jetës dhe integritetit fizik të njeriut paraqet vlerë të atillë e cila duhet të ruhet jo vetëm për interes individual por edhe për interesin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore.

Veprat penale kundër jetës dhe trupit paraqiten si një raport midis kryesit dhe viktimës, dhe në të shumtën e rasteve fajtor është kryesi, mirëpo ka raste ku edhe viktima kontribon në kryerjen e veprave penale, por me këtë çështje meret shkenca e viktimologisë.

Për veprat penale kundër jetës dhe trupit ekziston kodi penal i cili i sanksionon në mënyrë të duhur kryesit varësisht nga lloji i veprës. Në Kodin Penal të RM-së theksohet se ai i cili do ta privojë nga jeta tjetrin, do të dënohet me së paku 5 vjet burgim.

2.2 Llojet e veprave penale kundër jetës dhe trupit

Veprat penale kundër jetës dhe trupit të njeriut siç thamë më lartë janë vepra me të cilat personi privohet nga jeta apo i shkaktohet ndonjë lëndim trupor, pasojat nga këto vepra mund të jenë asgjësimi, rrezikimi apo dëmtimi i individit.

Këto vepra ndahen në disa grupe:

1. Vrasja (*Vrasja në mënyrë mizore, vrasja në mënyrë tinzare, vrasja me dashje me çrast rrezikohet jeta e personave tjerë, vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, vrasja me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale, vrasja nga hakmarja, vrasja nga motivet e ulëta, vrasja në bazë të porosisë, vrasja e gruas shtatzënë*)
2. Vrasje nga motive fisnike (*Eutanazia*)
3. Vrasja nga pakujdesia
4. Vrasja e foshnjës gjatë lindjes
5. Veprat penale kundër jetës së ardhshme (*Ndërprerja e palejuar e shtatzënisë*)
6. Veprat e rrezikimit (*Pjesmarja në rrahje, braktisja e personit të pa aftë, mosdhënia e ndihmës*).⁸

Veprat penale kundër jetës dhe trupit gjithashtu janë të parapra edhe në Kodin Penal të Republikës së Maqedonsë.

⁸ Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e posaçme, fq 3, Tetovë 2007

1. Vrasja- Është veprë e rëndë penale e kundërligjshme me anë të së cilës privohet apo i merret jeta një personi tjetër me dashje ose nga pakujdesia. Objekti i mbrojtjes të të gjitha veprat e vrasjes është jeta e njeriut, kurse subjekti i veprës penale të vrasjes mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën e caktuar me ligj për përgjegjësi penale⁹. Vrasja, në kuptimin e gjerë të fjalës, nënkupton shuarjen e jetës së njeriut. Krimi i vrasjes karakterizohet nga veprime ose mosveprime të kundërligjshme, të kryera në rrethana të veçanta në gjaknxehtësi, në zënie, rrahje apo grindje e sipër midis kryesit të vrasjes dhe viktimës, që këto zënie apo rrahje të kenë karakter serioz dhe të jenë të ndërsjella dhe të jetë shkaktuar pasojë, duhet të ekzistoj vdekja e viktimës, si pasojë e veprimit të paligjshëm. Vrasja kryhet edhe me anë të dhunës fizike, me anë të lëndëve helmuese, me anë të mbytjes ose me anë të kanosjes dhe frikësimit që sjell infarkt.¹⁰ Shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të vrasjet varet nga vetë rrethanat që bëhen shkak për kryerjen e veprës penale. Varësisht nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të llojeve të vrasjeve parashikohen edhe sanksionet penale të cilat fillojnë që nga burgimi i përjetshëm e deri në pesë vjet burgim.

Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 123** thuhet: Ai i cili do ta privojë tjetrin nga jeta do të dënohet me së paku 5 vjet burgim.

Më së paku dhjetë vjet burgim ose burgim të përjetshëm do të dënohet personi i cili:

“Do të privojë tjetrin nga jeta në mënyrë mizore apo tinzare”. Pasi që viktimës i jepet vuajtje e madhe fizike, dhe vrasja kryhet me intenzitet të lartë.

“Do të privojë tjetrin nga jeta dhe pastaj me dashje do ta sjellë në rrezik edhe jetën e ndonjë personi tjetër”. Pasi që kryersi vepron në ato rrethana me të cilat pajtohet ta vë në rrezik jetën edhe të ndonjë personi tjetër gjatë kryerjes së vrasjes.

“Do të privojë tjetrin nga jeta me qëllim të fitimit të dobisë pasurore”. Pasi që për shkak të egoizmit kryhet vepra penale që kryersi ti sjell vetes ndonjë dobi materiale.

⁹ Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e posaçme, fq 19, Tetovë 2007

¹⁰ http://www.kolegji-juridica.org/new_web/wp-content/uploads/2017/03/Dr.-Vesel-LATIFI-Zbulimi-dhe-të-provuarit-e-vrasjes.pdf

“Do të privojë tjetrin nga jeta për të kryer ose mbuluar ndonjë vepër tjetër penale”. Pasi që kryersi do ta privojë dikë nga jeta me qëllim që ta realizoj kryerjen e veprës tjetër penale (p.sh. kryersi hyn në market për të vjedhur dhe vret shitësin që të mund të kryej vjedhjen), ose kryersi do ta privojë nga jeta dikë me qëllim që të mos zbulohet vepra penale që e ka kryer më parë ose është duke e kryer.

“Do të privojë tjetrin nga jeta nga hakmarja ose motive të ulëta”. Pasi që kryersi do të privojë nga jeta një person nga xhelozia apo nga motive tjera të ulëta që janë në kundërshtim me rregullat etike-sociale.

“Do të privojë tjetrin nga jeta në bazë të porosisë”. Pasi që këtu ekziston vrasje e organizuar në bashkëpunim, ku mer pjes personi që urdhëron vrasjen dhe kryersi i vrasjes.

“Do të privojë nga jeta femrën, të cilën e di që është shtatzënë”.¹¹ Pasi që bëhet fjalë për marjen e dy jetërave të gruas shtatzënë dhe të foshnjës së pa lindur.

2. Vrasje nga motive fisnike (Eutanazia)- Eutanazia paraqet vrasjen e personit të sëmurë të pa shërueshëm që nuk ka shpëtim dhe është duke vdekur, që ti zvogëlohen dhimbjet gjatë vdekjes dhe të çohet deri te vdekja e shpejtë dhe pa dhimbje.¹²

Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 124** thuhet: Ai i cili do ta privojë tjetrin nga jeta nga motivet fisnike, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

3. Vrasja nga pakujdesia- Paraqet atë lloj të vrasjes kur dikush privohet nga jeta për shkak të pakujdesisë apo neglizhencës së kryerstit, pra nga moskujdesi vjen deri tek vrasja e ndonjë personi.

Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 126** thuhet: Ai i cili tjetërkënd do ta privojë nga jeta nga pakujdesia, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

¹¹ Kodi Penal i RM-së, neni 123, faqja 131

¹² Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e posaçme, fq 25, Tetovë 2007

4. Vrasja e foshnjës gjatë lindjes- Është veprë penale me anë të së cilës privohet nga jeta foshnja, e cila veprë kryhet nga nëna gjatë kohës së lindjes apo menjëherë pas lindjes.

Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 127** thuhet: Nëna e cila do ta privojë nga jeta fëmijën e vet gjatë kohës së lindjes apo drejtpërdrejt pas lindjes në gjendje çrregullimi i shkaktuar nga lindja, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet. Tentativa është e ndëshkueshme.

Te veprat penale të vrasjes bën pjesë edhe Shtytja në vetëvrasje dhe ndihma në vetëvrasje. Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 128** thuhet: Ai i cili tjetërkënd do të shtyjë në vetëvrasje ose do ta ndihmojë në kryerje të vetëvrasjes, e ajo do të kryhet, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.¹³

5. Veprat penale kundër jetës së ardhshme (Ndërprerja e palejuar e shtatzënisë)- Kjo veprë penale konsiderohet se është kryer në rastet kur dikush me pëlqimin e gruas shtatzënë ndërpret shtatzëninë, fillon ta kryej shtatzëninë ose i ndihmon që ta ndërpresë shtatzëninë. Kryersi i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person si p.sh mjeku, mamia apo ndonjë punonjës tjetër shëndetsor.¹⁴

Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 129** thuhet: 1) Ai i cili për kundër dispozitave për ndërprerjen e shtatzënisë, gruas shtatzënë me pëlqim të saj do ti kryej, do të filloj ti kryej ose do ti ndihmojë të kryej ndërprerje të shtatzënisë, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

2) Ai i cili merret me kryerjen e veprës nga paragrafi 1, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

3) Ai i cili gruas shtatzënë pa pëlqimin e saj do ti bëjë ose do të fillojë ti bëjë ndërprerje të shtatzënisë, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

4) Ai i cili pa pëlqim ose me sjellje në lajthim ose me shfrytëzim të mos dijes së gruas, duke qenë në kundërshtim me ligjin, me intervenim kirurgjik ose në mënyrë tjetër do ta ndërpres aftësinë e saj për reproduksion, do të dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

¹³ Kodi Penal i RM-së, neni 124, neni 126, neni 127, neni 128, faqja 132-133

¹⁴ Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e posaçme, fq 28, Tetovë 2007

5) Nëse vepra nga paragrafët 1), 2), 3) dhe 4) nga ky nen është kryer ndaj femrës së mitur ose është paraqitur çrregullim i rëndë trupor në shëndetin ose vdekjen e femrës, kryersi do të dënohet për veprën nga paragrafi 1) të këtij neni me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet, kurse për veprën nga paragrafët 2), 3) dhe 4) të këtij neni, do të dënohet me më së paku pesë vjet burgim.¹⁵

6. Veprat e rrezikimit (Pjesmarja në rrahje)- Kjo vepër bën pjesë në veprat penale që rrezikojnë. Konsiderohet se kryhet në rastet kur shkaktohet vdekja apo lëndimi i rëndë. Me rrahje nënkuptojmë përleshjen fizike të më shumë personave, së paku të tre personave. Si kusht objektiv për inkriminimin e kësaj vepre penale është privimi i tjetrit nga jeta apo shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore.¹⁶

Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 132** thuhet: 1) Ai i cili merr pjesë në rrahje në të cilën ndonjëri është privuar nga jeta ose ndonjë tjetrit i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

2) Nuk ka vepër penale nga paragrafi 1 për personin i cili pa fajin e tij është përfshirë në rrahje ose vetëm ka ndarë pjesëmarrësit e tjerë në rrahje.

Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 130** - Lëndimi trupor thuhet: Ai i cili tjetërkujt do ti shkaktojë lëndim trupor ose do t'ia keqësojë shëndetin, do të dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre vjet.

Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 131** - Lëndimi i rëndë trupor thuhet: Ai i cili tjetrin rëndë do ta lëndojë në trup apo rëndë do t'ia keqësojë shëndetin, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

(Braktisja e personit të pa aftë)- Nënkupton veprën penale të vrasjes, atëher kur për shkak të mos përkujdesjes apo neglizhencës ndaj personit të pa aftë i cili ka nevojë për ndihmë, respektivisht për shkak të braktisjes, personi i braktisur vdes.

¹⁵ Kodi Penal i RM-së, neni 129, faqja 134

¹⁶ Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e posaçme, fq 29, Tetovë 2007

Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 135** thuhet: 1) Ai i cili personin e paaftë, të cilit i është besuar apo për të cilin është i obliguar të kujdeset, do ta lë pa ndihmë në raste të rrezikshme për jetën apo për shëndetin, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

2) Nëse personi i lënë për shkak të kësaj e humb jetën apo ka lëndime të rënda trupore apo shëndeti i është prishur rëndë, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

(Mosdhënia e ndihmës)- Nënkupton veprën penale të vrasjes, atëher kur personit i cili ndodhet në gjendje rreziku për jetën dhe ka nevojë për ndihmë nuk i jepet ndihmë, dhe si rezultat i kësaj vjen deri te vdekja e tij. Pra është një vepër penale me mos veprim.

Sipas Kodit Penal të RM-së **Neni 136** thuhet: Ai i cili nuk do t'i jep ndihmë personit i cili gjendet në gjendje rreziku të jetës, edhe pse atë ka mundur ta kryejë pa ndonjë rrezik për vete apo për tjerët, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.¹⁷

¹⁷ Kodi Penal i RM-së, neni 132, neni 130, neni 131, neni 135, neni 136, faqja 135-137

2.3 Faktorët kriminogjen që ndikojnë te veprat penale kundër jetës dhe trupit

Ekzistojnë shumë faktorë të cilët ndikojnë në paraqitjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit, apo e nxisin individin në kryerjen e këtyre veprave penale. Qofshin ato faktorë që kanë të bëjnë me rethanat shoqërore, qofshin ato faktorë që kanë të bëjnë personalisht me natyrën e individit.

Nga ndikimi i faktorëve të ndryshëm personi mund të vijë deri në atë gjendje ku vendos të kryej vepër penale, faktorët qofshin ato të jashtëm apo të brendshëm, gjithnjë kanë ndikim tek secili individ, por varësisht se si individ përballet dhe i tejkalon ato faktorë apo thënë më qart ato ngacmime që vijnë nga jashtë, ashtu do të paraqitet dhe do të veprojë në shoqëri. (Psh në qoftëse personi është një tip me temperament kolerik: plot agresion dhe energji, nervozohet shpejt për gjëra të vogla dhe nuk është stabil, ai ndonjërin nga faktorët e jashtëm si: varfërinë papunësinë apo gjendjen e luftës nuk do të mund ti përballojë dhe tejkalojë më me butësi dhe qetësi dhe nga kjo gjendje e krijuar do të fillojë të meret me ndonjë sjellje devijante e cila më pas do ta çoj deri në kriminalitet).

Vrasjet ndodhin nga faktorë dhe motive të ndryshme, por në literaturën kriminologjike në përgjithësi më shumë flitet për faktorët e jashtëm si faktorë që kanë ndikim më të madh në kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit, siç janë: hakmarja, papunësia, varfëria, gjendja ekonomike, luftërat, vrasja për qëllime rrugaçërie, ose nga ndikimi i alkoolit, prostitucionit etj, pra gjithë këto faktorë të jashtëm që i kemi sqaruar edhe në kapitullin e parë kanë ndikim të madh në kryerjen e veprave penale, ato ndikojnë drejtpërdrejt në paraqitjen e aktiviteteve kriminale, dhe secili nga këto faktorë ka peshën e vet në paraqitjen e këtyre sjelljeve devijante.

Në vazhdim do të jap disa raste të vrasjeve të kryera nga ndikimi i faktorëve të ndryshëm të jashtëm:

“Para pak çastesh ka ndodhur një vrasje në fshatin Rashce të komunës së Sarajit. ALSAT mëson se është vrare personi me Iniciale Sh. Xh. 65-66 vjeç. Në vendngjarje ka forca policore. Vrasja ka ndodhur në hyrje të fshatit, motivet nuk dihen. Jozyrtarisht behet fjale për giakmarrje...”¹⁸

¹⁸ <https://www.alsat-m.tv/vrasje-ne-fshatin-rashce-te-sarajit/>

“Viktima H.Hyseni, 58-vjeç, nga Mitrovica, është vrarë me kallashnikov nga disa persona të dyshuar, të njohur për Policinë. Burimet e Indeksoline brenda policisë, kanë deklaruar se viktima para se të vritej, kishte marrë disa kërcënime nga disa persona të njohur për të dhe menjëherë kishte lajmëruar rastin në polici duke kërkuar ndihmë. Mirëpo, derisa policia kishte dalë në vendin e ngjarjes, të dyshuarit kishin kryer aktin e vrasjes së viktimës dhe kishin ikur në drejtim të panjohur. Mësohet se vrasja është kryer për motive të hakmarrjes, pasi që djali i viktimës, ditë më parë kishte kryer një plagosje. Indeksoline ka mësuar se për pak një predhë e kallashnikovit kishte goditur një pjesëtarë të policisë i cili ishte në hyrje të ndërtesës duke intervenuar në rast. Policia ende nuk ka arritur të arrestojë askënd në lidhje me këtë rast.”¹⁹

“Prokurori kompetent publik i Prokurorisë Themelore Publike –Tetovë së bashku me ekipet e ekspertizës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në orët e hershme të mëngjesit ka kryer ekspertizë në objektin në rrugën “29 Nëntori” në Tetovë, ku mbrëmë rreth orës 23:50 është vrarë një person, njoftojnë nga Prokuroria Themelore Publike. Vrasja ka ndodhur pasi në tavolinë një objekt kanë ndenjur pesë persona duke pirë alkool. Në një moment, vrasësi e ka nxjerrë pistoletën dhe ka gjuajtur në një nga personat duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse. Pas veprës penale të bërë ata kanë ikur, por më vonë dy prej tyre janë privuar nga liria nga ana e policisë, ndërsa dy të tjerët, mes të cilëve edhe vrasësi, vetë janë paraqitur në stacionin policor.”²⁰

¹⁹ http://time.ikub.al/a908c02d26/42a06c7e44c2cf31f122b5cf12b77733/lajm_Vrasja-me-kallash-per-motive-hakmarrje.aspx

²⁰ <https://portalb.mk/595239-pthp-eshte-kryer-ekspertize-ne-vendin-ku-ndodhi-vrasja-ne-tetove-vrasesi-eshte-paraqitur-ne-polici/>

III. KAPITULLI I TRETË

3. STUDIMI EMPIRIK MBI FAKTORËT KRIMINOGENE TE VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT

3.1 Prezentimi i rezultateve nga hulumtimi i bërë në gjykatën e shkallës së parë në Tetovë


Në këtë kapitull do të prezantohet rezultatat e hulumtimit të rasteve të mara nga gjykata e shkallës së parë në Tetovë, hulumtimi është bërë për periudhën 2010-2015 mbi veprat penale kundër jetës dhe trupit të njeriut më saktësisht mbi VRASJET dhe LËNDIMET TRUPORE, do të jap sqarime mbi atë se sa vepra penale të vrasjeve dhe lëndimeve trupore janë kryer brenda kësaj periudhe, cilin vit ka pasur numër më të madh të këtyre veprave penale etj.

VRASJET GJATË PERIUDHËS KOHORE 2010 - 2015

VRASJET	
VITI	NUMRI I VRASJEVE
2010	19
2011	20
2012	11
2013	7
2014	13
2015	11
Gjithsej 81	

Tabela nr 1

VRASJET GJATË PERIUDHËS KOHORE 2010 – 2015 ME PËRQINDJE



Grafikoni nr 1

Në tabelën e dhënë janë vendosur të dhëna për numrin e vrasjeve për periudhën 2010-2015, gjithsej brenda kësaj periudhe janë kryer 81 vrasje. Siç shihet nga të dhënat statistikore numri më i madh i vrasjeve ka qenë në vitin 2010 dhe 2011 diku rreth 23% dhe 25%, d.m.th këto kanë qenë vitet më të frekuentuara me vepra penale dhe njëkohësisht më të trishtuara për popullatën ku numri i vrasjeve ka qenë më i madh, kurse më pas vitin e ardhshëm në vitin 2012 numri i vrasjeve është ulur për 9 vepra më pak d.m.th nga 25% është ulur në 13%, dhe në vitin 2013 përsëri është ulur numri për 4 vepra më pak në 9%, ky ka qenë viti me më pak vepra penale të vrasjeve, mirëpo më vonë në vitin 2014 është ritur numri për pak në 16%, dhe në vitin 2015 përsëri është ulur numri për 2 vepra më pak në 14%.


Nga gjithë kjo që shihet, mund të themi se numri i veprave penale të vrasjeve viteve në vazhdim shkon duke u zvogëluar, pasi që nga 20 vepra të kryera në vitin 2011, vitin e fundit numri ka ra në 11 vepra, gjë që është shumë pozitive mund të shihet se ka pasur një farë lloj risocializimi të shoqërisë brenda kësaj periudhe.

LËNDIMET TRUPORE GJATË PERIUDHËS KOHORE 2010 - 2015

LËNDIMET TRUPORE	
VITI	NUMRI I LËNDIMEVE TRUPORE
2010	47
2011	67
2012	67
2013	40
2014	50
2015	44
Gjithsej 315	

Tabela nr 2

LËNDIMET TRUPORE GJATË PERIUDHËS KOHORE 2010 – 2015 ME PËRQINDJE



Grafikoni nr 2

Në këtë tabelë kemi të dhëna mbi numrin e lëndimeve trupore për periudhën 2010-2015, gjithsej brenda kësaj periudhe janë kryer 315 lëndime trupore. Ku shihet se numri më i madh i lëndimeve trupore ka qenë në vitin 2011 dhe 2012 67 vepra diku rreth 21%, më herët në vitin 2010 numri i lëndimeve trupore ka qenë pak më i ulët 47 d.m.th 15%, kurse dy vitet e ardhshme që u cekën më lartë ka hyrur numri dhe kanë qenë vitet më të rrezikshme për shoqërinë me numrin më të madh të lëndimeve trupore. Kurse më pas në vitin 2013 numri i këtyre veprave ka rënë për 27 vepra më pak d.m.th 13%, gjë që është shumë pozitive për shoqërinë në përgjithësi, ky ka qenë edhe viti me më pak vepra të lëndimeve trupore brenda këtyre 6 viteve. Më pas në vitin 2014 numri ka hyrur për pak në 50 vepra d.m.th 16 %, kurse në vitin 2015 numri i lëndimeve trupore përsëri ka rënë për 6 vepra më pak d.m.th ka pasur 44 vepra apo 14%.

Nga gjithë këto të dhëna statistikore rezulton se edhe te lëndimet trupore numri më i madh i veprave ka qenë në vitet 2011 dhe 2012, kurse më pas vitet në vazhdim numri i lëndimeve trupore ka filluar të ulet, pasi që nga 67 vepra numri ka ra në 44, edhe kjo është një lloj

informimi se me kalimin e kohës shoqëria ka filluar pak të stabilizohet dhe të risocializohet. D.m.th. viti 2011 ka qenë viti më i keq për shoqërinë në rrethin e Tetovës, pasi që ka qenë viti me numrim më të madh të veprave penale edhe të vrasjeve edhe të lëndimeve trupore, nuk mund të dihet saktësisht se cilat kanë qenë arsyet e vullshmërisë kaq të madhe të këtyre veprave në këtë vit, mirëpo sipas mendimit tim ndoshta kanë qenë shkak krizat dhe depresionet ekonomike, konfliktet politike apo edhe gjendja e luftës. Edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë pas luftës dmth nga viti 2001 deri në vitin 2011 mirëpo edhe vitet në vazhdim pas luftës nëpër shumë vende kriminaliteti është i përhapur deri sa të arihet stabilizimi i shoqërisë pas pasojave që ka sjellur gjendja e luftës, si p.sh. nga konfliktet politike të cilat risin tensionet mes popullatës dhe sjellin periudha të vështira në shoqëri. Gjithashtu edhe krizat dhe depresionet ekonomike prishin balancin në shoqëri dhe krijojnë kriza në të gjitha institucionet, pra ndoshta këto kanë qenë disa nga arsyet dhe faktorët që kanë ndikuar në numrin më të madh të veprave penale në këtë vit, kurse më vonë vitet në vazhdim me kalimin e kohës janë tejkaluar këto kriza, gjendja e shoqërisë ka filluar të përmirësohet prandaj edhe përqindja e veprave penale ka filluar të ulet.

Nga ky hulumtim i bërë në qoftëse marim të analizojmë në përgjithësi dallimin midis asaj se a janë kryer më shumë vepra penale të vrasjeve apo të lëndimeve trupore brenda këtyre viteve, natyrisht që del se më shumë ka pasur lëndime trupore se sa vepra penale të vrasjeve. Pasi që nga ato vepra të lëndimeve trupore ndoshta disa më pas kanë pësuar në vdekje kurse shumica kanë ngelur vetëm lëndime trupore. Prandaj edhe numri i lëndimeve trupore në përgjithësi është 315, kurse i vrasjeve 81. Pasi që lëndimet trupore në përgjithësi janë vepra penale që ndodhin më shpesh dhe që vijnë edhe si rezultat i ndonjë zënke apo përleshjeje të vogël mes palëve, kurse veprat penale të vrasjeve në krahasim me lëndimet trupore janë vepra që ndodhin pakës më rrallë dhe konsiderohen vepra penale të rënda që pasojnë edhe me dënime më të rënda.

3.2 Prezentimi i rezultateve nga intervista me persona kompetent

Në këtë pjesë kam bërë intervistë me personat kompetent të gjykatës së shkallës së parë në Tëtovë si me gjykatës prokuror etj, në lidhje me veprat penale të vrasjeve dhe lëndimeve trupore, personat kompetent kanë dhënë mendimin e tyre për rastet që kanë ndodhur në rrethin e Tetovës në lidhje me atë se si mendojnë ato: cilët nga faktorët kanë pasur ndikim më të madh në kryerjen e këtyre veprave penale, dhe dënimet që u jepen a janë efektive për kryersit, a ndikojnë në risocializimin e tyre, apo kemi recidivist të këtyre veprave penale!

Sipas intervistës së bërë në gjykatën e shkallës së parë në Tetovë, gjykatësi dhe prokurori dhanë disa perceptime të tyre duke u bazuar në rastet që kanë ndodhur në këtë gjykatë, dhe nga kjo intervistë mund të vi në këto përfundime: Së pari në rrethin e Tetovës nga këto vepra më tepër kemi lëndime trupore se sa vrasje, vrasjet janë me numër më të ulët, ka tentime për vrasje të cilat zakonisht përfundojnë në lëndime trupore kurse fatmirsisht vrasje ka më pak. Në lidhje me pyetjen se cilët nga faktorët ndikojnë më shumë në kryerjen e veprave penale të vrasjeve dhe lëndimeve trupore, erdhëm në përfundim se motivet apo faktorët që e shtyjnë individin të kryej një vepër penale të vrasjes janë personale, varësisht se si individi e percepton situatën që është ngacmuar nga jashtë ashtu edhe do të veprojë, deri te vrasja zakonisht vjen nga ndikimi i më tepër rrethanave p.sh. në qoftëse një person ka pasur ndonjë zënkë më parë me një person tjetër dhe në qoftëse përsëri vjen rasti deri në atë shkallë që të kenë ndonjë konflikt e gjitha varet nga ajo se si personi do ta perceptojë situatën dhe si do ta tejkalojë atë pra varet nga gjendja shpirtore e tij, a do ta kalojë me qetësi dhe me heshtje apo do të kthehet në ndonjë zënkë verbale me sharje, ofendime apo do të vijë edhe deri në atë shkallë ku do të përfundoj rasti me vepër penale të vrasjes. Motivët zakonisht janë momentale dhe vijnë si rezultat i mostolerancës. D.m.th këtu vijnë në shprehje edhe faktorët e brendshëm të cilët kanë të bëjnë me personalitetin e individit sepse do të varet nga ajo se si individi do të përballet me situatën, por vijnë në shprehje edhe faktorët e jashtëm siç janë faktoret mikrogrupor: familja, mjedisi social etj, ose faktorët ideopolitik siç janë: papunsia, varfëria, kushtet e vështira të banimit, apo faktorët socio patologjik siç janë: alkooli, narkomania, bixhozi etj. Sepse për zënkën e cila ka ndodhur shkak shtytës ka qenë ndonjëri nga këto faktorë të jashtëm, dhe më pas kur është tensionuar situata ka ardhur deri te vrasja ndoshta në mënyrë momentale por shkak dhe faktor që e nxit individin ta kryej një vepër penale zakonisht janë ndonjëri nga këto faktorë të jashtëm. Pra mund të vimë në

konkluzion se zakonisht te rastet e vrasjeve dhe lëndimeve trupore **kombinohen të dy llojet e faktorëve shkak janë edhe faktorët e jashtëm edhe faktorët e brendshëm**, më të ralla janë rastet kur ndikon vetëm njëri lloj i faktorve apo tjetri. Edhe niveli i ulët i arsimimit nga faktorët e jashtëm ka ndikim të madh në kryerjen e veprave penale sepse individi për shkak të arsimimit të ulët dhe mos socializimit të tij nuk do të mund ta perceptojë situatën më me kujdes, me mençuri dhe të mendojë për pasojat që do t'ia sjell kryerja e asaj veprave penale por do të veprojë në çast dhe pa mos e analizuar situatën më gjatë dhe kështu do të vijë deri te kryerja e veprës penale, **pra zakonisht ka përzierje të faktorëve në kryerjen e këtyre veprave penale**, por pak më shumë ndikojnë faktorët e jashtëm sepse zakonisht vrasjet kryhen edhe si shkak i papunsisë, varfërisë, apo edhe si rezultat i asaj se individi rrjedh nga ndonjë familje e degraduar, apo edhe si shkak i alkoolit, narkomanisë etj.

Ka edhe një mendim tjetër se edhe viktima zakonisht ndikon që të kryhet vepra penale, sepse vepra mund të kryhet si rezultat i provokimit të viktimës, dhe vepra penale e vrasjes mund të jetë momentale, dhe e kryer për shkak të provokimit të viktimës...

Për pyetjen se çfarë dënime zakonisht u jepen kryersve dhe a janë efektive për kryersit, a ndikojnë në risocializimin e tyre, apo kemi recidivist të këtyre veprave penale mora përgjigje se: Dënimet për vrasje që i jep gjykatësi me të cilin e bëra intervistën, zakonisht janë të ashpra, më të mëdhaja prej nga 10 vite 20 ose 40 vite burgim varësisht nga lloji i vrasjes. Kurse burgim të përjetshëm u shqipton kryersve në ato raste kur vepra penale është më e madhe, kur ka elemente rënduese, nëse vepra penale është kryer gjatë ushtrimit të dhunës, nëse personi është privuar nga jeta në mënyrë tepër mizore, nëse ka më shumë persona të lënduar apo janë vrarë më shumë persona etj. Kurse sipas gjykatësit shumë rallë mund të ketë recidivist të këtyre veprave penale, vetëm në qoftëse kryersi është një vrasës i cili edhe më parë ka kryer kësi lloji të veprave penale, kurse personi i cili njëher ka kryer një vepër penale të vrasjes pas dënimit që i është shqiptuar me 20 vite ose 40 vite burgim nuk ka kryer përsëri një vepër të tillë, pasi që dënimi ka qenë i ashpër, pra këto dënime që u shqiptohen kryersve janë efektive ndikojnë në një farë mënyre në risocializimin e tyre që mos kryejnë përsëri vepra të tilla, prandaj edhe nuk ka recidivist të këtyre veprave penale sepse kanë ndikim dënimet e ashpra.

Nga e gjithë kjo intervistë mendimi im është se në kryerjen e veprave penale të vrasjeve dhe lëndimeve trupore ndikojnë të dy llojet e faktorëve dhe janë të kombinuar por më tepër janë shtytës faktorët e jashtëm siç janë: papunsia, varfëria, krizat ekonomike, familja, ambienti, rethi, shoqëria, ndikimi i alkoolit, hakmarja etj. Ka raste ku edhe faktorët e brendshëm ndikojnë në kryerjen e këtyre veprave penale p.sh kryersi është person që është i sëmurë në pikpamje shpirtërore dhe mendore, është person me çregullime mentale, mirëpo këto raste janë me numër më të vogël. Kurse me numër më të madh janë rastet e veprave penale që kryhen nga ndikimi i faktorëve të jashtëm, këto faktorë janë më ngacmues për individin paraqesin rethana determinuese të sjelljes kriminale, edhe pse janë të shumtë por secili ka rolin e vet në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Në qoftëse krahasojmë se cili nga faktorët e jashtëm ndikon më shumë në kryerjen e këtyre veprave penale, nuk mund të japim një konkluzion të saktë, sepse këto faktorë janë të lidhur ngusht me njëri tjetrin dhe secili mund të ndikojë në kryerjen e këtyre veprave penale varësisht nga karakteri dhe tipi i kryerstit, dhe gjithashtu nga mënyra e jetesës së tij. P.sh kushtet ekonomike janë një faktor shumë i rëndësishëm që mund ta shtyjë individin të kryej një vepër penale, sepse ai për shkak kushteve jo të mira për jetesë, me qëllim që të arrijë diçka do të filloj të meret me sjellje devijante, si p.sh do të pijë alkool apo do të shkojë të vjedh diçka me qëllim që të bëj diçka për jetesën, dhe kështu ai do të kryej ndoshta edhe një vepër penale të vrasjes apo lëndimeve trupore. Por edhe familja nga ana tjetër është një faktor shumë i rëndësishëm për individin që ndikon në kryerjen e këtyre veprave penale, p.sh në qoftëse individi rrjedh nga një familje e degraduar dhe e çregulluar ai mund që nga kjo gjendje të filloj të meret me sjellje devijante që më pas e shtyjnë edhe në kryerjen e veprave penale. Prandaj mund të themi se secili nga faktorët e jashtëm e ka peshën e vet në kryerjen e veprave penale të vrasjeve apo lëndimeve trupore.

3.3 Studimi i rasteve konkrete

Në këtë pjesë do të analizoj më hollësisht 2 raste të mara nga gjykata e shkallës së parë në Tetovë, një për vrasje dhe një për lëndime trupore. Do të jepen të dhëna për kryerjen e veprës penale, aktgjykimi apo aktvendimi i veprës penale, dënimet që janë shqiptuar, faktorët që kanë ndikuar në kryerjen e veprave penale etj.

Vrasje

“Njëri nga rastet që do ta prezentoj është një vrasje që ka ndodhur në rrethin e Tetovës në vitin 2011 në muajin tetor, midis 2 personave ku kryersi ishte person madhor kurse i dëmtuari tani më i vdekuri ishte i mitur. Vrasja më konkretisht ka ndodhur për shkak një zënke verbale mes dy të rrinjëve që ka ndodhur një dit më parë në shkollë, ku kryersi ka kërkuar para nga i dëmtuari për të hyrë ai në shkollë me shaka.. për shkak të këtyre fjalëve i dëmtuari i është kërcënuar të pandehurit dhe kështu ai nuk ia ka hapur derën që të hyjë në shkollë, më pas ai ka hyrë në shkollë pasi ia ka hapur derën tjetër shok, dhe kështu me të nuk kanë pasur më kontakte. Ditën kritike reth orës 13:00 i pandehuri ka qenë ulur si çdo ditë në një ulëse të vendosura para pallatit të kulturës me shokët e tij dhe kanë pritur autobusin për të shkuar në fshatin ku banonin, në një moment ka ardhur i dëmtuari bashkë me 2 shokët e tij, ku i dëmtuari është ndalur para të pandehurit në një largësi prej 1 metre dhe ka filluar ta ofendoj me fjalë ofenduese dhe sharje të pandehurin, dhe është munduar ti bjerë, personi tjetër i cili është munduar ta mbaj të dëmtuarin që mos i bjere të pandehurit në një moment e ka lëshuar të dëmtuarin dhe kështu ai ka aritur që ti sjell një grusht të pandehurit në fytyrë të cilit i ka lënë disa lëndime në sy dhe në atë moment i pandehuri ngrihet nga ulësja e nxjer pistoletën nga xhepi i pantallonave të cilën e ka pasur në mbajtje pa leje, dhe në momentin kur i dëmtuari ka qenë në një largësi prej 1 metre ka krisur drejt të dëmtuarit 2 herë, një herë në gjoks dhe një herë në pjesën e poshtme në anën e majtë, për shkak të lëndimeve të mara i dëmtuari ka humbur jetën menjëherë në vendin e ngjarjes . Nga rasti i frikësuar kryersi menjëherë e ka lëshuar vendin e ngjarjes dhe me autostop ka ikur për në fshatin e tij dhe rrugës e ka hudhur pistoletën diku në ndonjë vend të panjohur, pasi ka ikur në fshat 2 ditë ka qëndruar tek shoku i tij kurse më pas është paraqitur në polici”.

Për këtë rast është ngritur akt akuzë nga prokuroria publike ndaj të pandehurit për veprën penale vrasje dhe mbajtje pa leje e armëve, dhe kërkohet nga gjykata që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit dhe kodit penal.

- Aktgjykimi: Për këtë rast konstatohet se i pandehuri ka kryer 2 vepra penale një vrasje dhe një mbajtje pa leje të armëve, dhe për këto vepra gjygi i jep të pandehurit këto dënime: për veprën penale vrasje nga neni 123 paragrafi 2 i jep dënim me burgim në kohëzgjatje prej 12 vite dhe 6 muaj, kurse për veprën penale mbajtje, ndermjetësim dhe tregti e paautorizuar e armëve neni 396 paragrafi 1 i jep dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite. Pra dënimi unik është burgim në kohëzgjatje prej 14 vite.

Sipas gjygjit mendohet se ky dënim pershtatet me shkallën e përgjegjesisë penale të të pandehurit, dhe është i mjaftueshëm për të pandehurin që në të ardhmen mos kryej përsëri kështu vepra penale apo të ngjashme.

Sipas dëshmimeve të dëshmitarëve dhe vetë të të pandehurit del në pah se vrasja nuk ka qenë një vrasje casti (sepse për të qenë ashtu i pandehuri duhej të ishte pa fajin e tij, duhej të kishte ndonjë përleshje të fuqishme me dhunë, apo ofendim të rëndë nga ana e të dëmtuarit, dhe i pandehuri duheshte të ndjehet i frikësuar) kjo nuk ka ndodhur, por ka qenë me paramendim pasi që i pandehuri fiks ditën kritike e ka mbajtur pistoletën me vete dhe e ka përdorur atë, pistoletën e ka mbajtur me vete edhe në shkollë jo vetëm në fshat sepse edhe i dëmtuari mëson në të njëjtën shkollë, edhe atë duke e ditur se një ditë më parë ka pasur zënka me të dëmtuarin, dhe me të njëjtën pistolet ka gjuajtur drejt tij ku ka qenë i vetëdijshëm se me të mund ta vrasë të dëmtuarin, dhe përsëri ka gjuajtur 2 herë drejt tij. Edhe për mbajtjen e pistoletës i pandehuri dënohet pasi e ka pasur në mbajtje pa leje, dhe për këtë arsye gjygi e dënon me 14 vite burgim për të dy veprat. **Ku sipas Kodit Penal të RM-së neni 123 paragrafi 2 për këtë vepër penale të vrasjes parashihet dënim me më së paku 10 vite burgim ose burgim të përjetshëm.** Dënimi i është dhënë duke u marur parasysh edhe rethanat lehtësuese dhe rënduese ku si rethana rënduese është marur fakti se i pandehuri disa ditë ka ikur nga organet e sigurisë, kurse si rethana lehtësuese janë marur faktet se i pandehuri është person i rri, nuk ka qenë i dënuar më parë etj.

-Nga ky rast mund të vim në përfundim se faktorët që kanë ndikuar më shumë në këtë veprë penale të vrasjes janë faktorët e jashtëm, faktorët mikrogruporë ku bëjnë pjesë familja, ambienti shkollor, mjedisi social etj- të cilat janë një ndër grupet primare ku realizohet procesi i edukimit zhvillimit, formimit dhe socializimit të personlitetit të njeriut, dhe në këtë rast kto institucione shoqërore kanë qenë me ndikim negativ në paraqitjen e sjelljeve kriminale te ky person, pasi që zënka ka ndodhur për arsye të një përlshjeje verbale mes shoqërisë në shkollë, por gjithashtu edhe familja ka ndikuar negativisht tek ky person pasi që në deklaratë i pandehuri ka thënë se pistoletën ia ka dhënë dhe e ka mësuar ta përdor një familjar të cilit nuk ia jep të dhenat... pra këtu edhe familja paraqitet si faktor negative dhe shtytës që ka ndikuar në kryerjen e veprës penale sepse pistoletë me të cilën është kryer vrasja i është dhënë nga një familjar.

Lëndim trupor

“Ky rast ka të bëjë me një lëndim trupor që ka ndodhur në rethin e Tetovës në vitin 2014 në muajin gusht, mes dy personave ku e dëmtuara ishte grua kurse kryersi ishte mashkull i cili ishte vëllau i të dëmtuarës, atë ditë në shtëpinë e të dëmtuarës përderisa ajo ishte duke pushuar, tek dera ra zilja ku aty ishte vëllau i saj tashmë i pandehuri, ku me sa u hap dera e hymjes nga ana e të pandehurit i cili ishte në gjendje të alkoolizuar, menjëherë pa arsye filloi ta sulmojë të dëmtuarën fizikisht, në atë mënyrë ku disa herë e sulmoi me grusht në kokë dhe i la lëndime të shumta si: shtypje në kokë, rahje ne fytyrë, gërvishje në pjesën e qafës në anën e majtë etj. Me të cilat veprime i ka shkaktuar të dëmtuarës lëndime trupore”.

Për këtë rast është ngritur padi private nga paditësja (e dëmtuara), e cila padinë e ka paraqitur përmes avokatit, me të cilën padi e paraqet fajtor kryersin për veprën penale lëndim trupor nga neni 130 paragrafi 1. Dhe e dëmtuara përmes avokatit kërkon nga gjykata që i pandehuri të shpallet fajtor për veprën penale që e ka kryer dhe të dënohet sipas ligjit. Pasi që për veprën penale lëndim trupor nga paragrafi 1 ndjekja ndërmerret me padi private, kurse për lëndime trupore gjatë kryerjes së dhunës familjare ndjekja ndërmerret me propozim.

-Aktgjykimi: Për këtë rast konstatohet se i pandehuri ka kryer veprën penale lëndim trupor sipas nenit 130 paragrafi 1, dhe për këtë veprë gjygi i jep të pandehurit këtë dënim: dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajsh.

Sipas gjyqit mendohet se dënimi efektiv me burgim 3 muaj është adekuat me peshën e kryerjes së veprës penale dhe pershtatet me përgjegjësinë penale të të pandehurit, dhe do të ndikojë tek i pandehuri që në të ardhmen mos kryej përsëri kështu vepra penale apo të ngjshme.

Sipas Kodit Penal të RM-së neni 130 paragrafi 1 për këtë veprë penale të lëndimit trupor parashihet dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 vjet. Dënimi që i është dhënë të pandehurit i është shqiptuar duke u marur parasysh edhe rethanat lehtësuese dhe rënduese ku si rethanë rënduese është marur fakti se ky lloj i veprave penale shumë shpesh paraqitet në këtë teritor, si dhe rreziku i madh që paraqitet nga ky lloj i veprave penale reflektohet në mesin ku jetojnë të dëmtuarit dhe të pandehurit dhe gjithashtu prish qetësinë e popullatës në reth, ndjenja e pasigurisë për lëvizjen e lirë etj. Kurse si rethanë lehtësuese është vlerësuar vetëm gjendja materiale e të pandehurit.

-Edhe te ky rast mund të vim në përfundim se faktorët që kanë ndikuar më shumë në këtë veprë penale të lëndimeve trupore janë faktorët e jashtëm, faktorët socio-patologjikë ku bëjnë pjesë alkoolizmi, narkomania, bixhozi etj. Alkoolizmi është një ndër faktorët sociopatologjik i cili është mjaft i përhapur në ditët e sodit, nga alkooli paraqitet dëmtim i shëndetit fizik, psiqik dhe social, dhe kështu personat bëhen pjesë e veprimeve devijante, pasi që nga konsumimi i tepërt i alkoolit mund të kenë çrregullime të marrëdhënieve me personat tjerë, u zvogëlohet edhe ndjenja e përgjegjësisë dhe botës reale dhe kështu për shkak të pandjesisë mund të kryejnë edhe vepra penale. Ku edhe në rastin konkret i pandehuri shkon tek shtëpia e motrës së tij dhe fillon të sulmojë atë fizikisht dhe të shkaktojë lëndime trupore pa arsye vetëm se ka qenë në gjendje të alkoolizuar dhe ka humbur kontrollin, pra del në pah se faktorët që kanë ndikuar negativisht dhe që kanë qenë shtytës në kryerjen e kësaj vepre penale janë faktorët sociopatologjikë- konkretisht në këtë rast alkooli.

IV. KAPITULLI I KATËRT

4. PARANDALIMI I KRIMEVE TË DHUNËS

Termi prevencion është huazuar në mënyrë pragmatike nga vokabulari dhe praktika mjekësore, që në gjuhën latine, praeventio dmth parandalim, mbrojtje paraprake, pengim, shmangie që më pare. Nga ky kategorizimi, mund të vërehet se nocioni parandalim përmban në vete të gjitha masat e ndërmarra në mënyrë të planifikuar, të paramenduar dhe të organizuar me të cilat do të bëhen përpjekje të mënjanoen ose së paku të zvogëlohen shkaqet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të sjelljeve të dënueshme. Lidhur me këtë disa autorë theksojnë se parandalimi nënkupton shumësinë e të gjitha masave, të mjeteve dhe të teknikave, që kanë për qëllim zvogëlimin e llojeve të ndryshme të dëmeve të shkaktuara me vetë ekzekutimin e veprës, që shteti i ka shënuar ose inkriminuar në Ligjin e vet penal si vepër penale.

Si koncept i përkrahur dhe i themeluar social i aktivitetit, parandalimi paraqet padyshim frontin më të gjerë dhe më human në luftë kundër kriminalitetit në bashkësitë bashkëkohore shtetërore. Parandalimi i kriminalitetit përfshin veprime të niveleve të ndryshme me të cilat bëhen përpjekje të pengohen sjelljet kriminale dhe të zvogëlohet numri i tyre para se të konkretizohet akti kriminal.

Qëllimi i parandalimit të kriminalitetit është pengimi i një vargu të tërë të veprimeve të ndryshme kriminale siç janë: deliktet pasurore, deliktet lidhur me drogën, deliktet e dhunës pastaj, sot për opinionin delikti interesant dhe shumë i shfrytëzuar nga ana mediale i kriminalitetit të organizuar etj.²¹

21

<https://www.google.com/search?q=parandalimi+i+krimit&spell=1&sa=X&ved=0ahUKEwilqIGkq8fjAhUGxIsKHdrjA1gQBQgqKAA&biw=1455&bih=726>

Vrasjet dhe lëndimet trupore si vepra penale të orientuara kundër jetës dhe trupit të njeriut, paraqesin pengesë kryesore për lirinë e lëvizjes dhe sigurinë brenda një territori të caktuar, vendi apo shteti. prandaj shihet si nevojë urgjente parandalimi apo pengimi i kësaj dukurie mjaft shqetësuese e cila çdo ditë e më shumë ka progres në kuptim të rritjes së numrit të vrasjeve.

Preventiva e kriminalitetit i përfshinë aktivitetet e subjekteve të ndryshme që ndërmarrin masa preventive-parandaluese. Ato masa preventive ndaj kriminalitetit mund të ndërmerren nga: organet shtetërore, dhe organet me autorizime publike, por mund të ndërmerren edhe nga organizatat joqeveritare, nga shoqatat, nga fondacionet private, nga institucionet e informimit publik: shtypi, mediat elektronike etj, gjithashtu mund të ndërmerren nga institucionet arsimore, nga rrethi profesional në kuptimin e gjerë të fjalës, nga institucionet fetare dhe nga familja si grupi themelor shoqëror i secilës shoqëri.

Parandalimi i krimeve të dhunës mund të arrihet me aktivitetin e vetë shtetit në këtë plan i cili duhet të fokusohet në nxjerrjen dhe sendërtimin e projekteve ligjore, që do të thotë dizajnimin e legjislacionit penal, pastaj operacionalizimin e tij përmes masave preventive policore dhe shërbimeve të tjera të specializuara shtetërore, që merren me luftën kundër kriminalitetit. Megjithatë, siç u theksua, preventiva ndaj kriminalitetit shpeshherë ka të bëjë me zbatimin e masave të caktuara nga vet qytetarët, në mënyrë të pavarur apo përmes organeve dhe shërbimeve të specializuara, përmes shoqatave të krijuara në mënyrë spontane apo të planifikuara, si dhe përmes disa sektorëve të jetës shoqërore, siç është sektori i informimit etj. Me masat e preventivës ndaj kriminalitetit nënkuptohen aktivitetet e organeve shtetërore dhe të tjerëve të orientuara për pengimin e dukurive negative shoqërore, të cilat shkaktojnë pasoja të dëmshme dhe të ndaluara, si dhe krijimin e kushteve për çrrënjosjen e tyre. Nuk ka dyshim që për çrrënjosjen e kriminalitetit është jashtëzakonisht e rëndësishme që vepra penale të zbulohet në tërësi dhe në tërësi të shpjegohet, për këtë shkak është e nevojshme që të krijohen kushte të atilla që praktikën t'ia ofrojnë ideale të asnjë vepër penale të mos mbetet e pazbuluar dhe e pazbardhur, që asnjë fajtor të mos mund të ikë përgjegjësisë penale si dhe asnjë person i pafajshëm mos të thirret për përgjegjësi penale dhe të mos dënohet.²²

²² <https://www.botasot.info/opinione/596326/vrasjet-ne-kosove-dhe-rol-i-organeve-shteterore-ne-parandalimin-e-vrasjeve/>

Krime ndodhin edhe në vende të zhvilluara por janë arritur dhe njihen disa standarde, edhe pse dinamika dhe intensitetet kanë luhatur dhe zhvillohen me ulje ngritje vështuar në kohë dhe hapësirë, por ende mungojnë të dhëna të sakta policore, gjë që reflektohet kur hedh një sy në statistika. Thënë në mënyrë të përmbledhur, disa drejtime që duhet të ndikojnë në parandalimin e kriminalitetit dhe në goditjen e akteve me rrezikshmëri më të theksuar mund të rendisim: Së pari, përmirësim i situatës ekonomike, normaliteti i marrëdhënieve në shoqëri duke filluar nga komunitetet dhe në të gjitha hallkat e strukturat të ekzekutivit, legjislativit, gjë që kërkon realizimin e reformave me karakter të theksuar social dhe që do të sjellin në një afat kohor më të shpejtë përmirësimin e kushteve jetësore të shoqërisë. Vëmendje më e madhe duhet ti kushtohet shtresave të varfëra, gjë që kërkon hapësira për angazhime dhe veprimtari ekonomike, në sferën prodhuese por dhe atë të shërbimeve, kujdes i veçantë për shkollimin e të miturve gjë që kërkon përmirësimin dhe ngritjen cilësore të shkollave të të gjitha kategoritë. Së dyti, ndryshime të dukshme kërkohen në strukturat e specializuara sidomos në shërbimet e policisë ku duhet të ndryshojë rrënjësisht metoda e punës për: afrimin në komunitet, parandalimin e krimit në rradhë të parë tek të miturit, të ju kushtohet vëmendje të miturve që braktisin familjet etj.²³

Pra mendoj se disa rethana apo drejtime të cilat në të ardhmen mund të pengojnë sjelljet devijante dhe të dënueshme dhe nga të cilat do të ulet numri i veprave penale janë: së pari ngritja e nivelit të vetëdijes së njeriut, njerzimi në përgjithësi duhet të vetëdijsohet të ketë më tepër tolerancë dhe të mendojë më gjatë dhe më hollësisht për pasojat që sjell kryerja e atyre veprave penale, arsimimi më i lartë i shoqërisë sidomos vëmendje e veçantë duhet kushtuar për të miturit që në të ardhmen të dalin të arsimuar dhe të edukuar në një nivel normal që të mund të dallojnë të mirrën prej të keqes , kushtet më të mira ekonomike që mos vijë deri tek vrasjet dhe lëndimet trupore për shkak të pamundësisë së plotësisht të kushteve elementare për jetesë, si dhe familja e shëndoshë dhe e regullt pasi që faktori i mjedisit familjar ka rëndësinë themelore në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit sepse familja në të vertetë ka karakter pedagogjik të personalitetit në edukimin dhe formimin e anëtarëve të rinj të shoqërisë që konsiderohet si funksion kryesor social i saj, etj.

²³ <https://sot.com.al/opinione/rritja-e-kriminalitetit-dhe-lufta-ndaj-tij>

Masa paraprake për parandalimin e krimeve të dhunës gjithashtu duhet të ndërmeren edhe nga shteti dmth autoritetet shtetërore si për shembull: agjencitë shtetërore, parlamentet, zyrtarët, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile por edhe shoqatat e ndryshme të gjithë të angazhohen në nxjerrjen e projekteve kundër kriminalitetit dhe të veprojnë në përputhje me këtë detyrim. Krimi është fundi i një cikli që fillon me mostolerancë dhe paragjykime. Prandaj gjitha këto organe duhet të ndërmarin masa preventive dhe të punojnë bashkërisht në parandalimin e kriminalitetit për të pasur një jetë më të mirë dhe në paqe për gjithë shoqërinë.

Përfundimi

Si rezultat i shqyrtimit të literaturës, dhe hulumtimit të rasteve në këtë tezë është marë parasysh dhe është hulumtuar për etiologjinë kriminale në përgjithësi, ndikimi i faktorëve etiologjik te krimet kundër jetës dhe trupit të njeriut, llojet e veprave penale kundër jetës dhe trupit të njeriut ku jam bazuar në të dhëna për 2 grupe veprash penale si vrasje dhe lëndime trupore, si një ndër faktorët nga kërcënuesit më kryesor të rrezikimit të sigurisë dhe jetës së njeriut si në nivel rajonal, po ashtu edhe atë ndërkombëtar, si dhe janë ulmtuar në hollësi studimi i rasteve të vrasjeve dhe lëndimeve trupore të marra nga gjykata e shkallës së parë në Tetovë.

Në rrethin e shoqërisë ku jetojmë ditët e sodit, kërcënimi kundër jetës së njeriut është një nga format më të shpeshta dhe më shqetësuese që shoqëria jonë ka hasur gjatë gjithë kësaj periudhe dhe dukshëm kjo gjë po shkon në rritje. Prandaj në këtë hulumtim u mundova të jap një shpjegim dhe analizë të këtij fenomeni shqetësues dhe rrezikues që dita ditës po shkon në rritje numri i veprave penale të rënda kundër jetës dhe trupit të njeriut. Dhe u mundova të jap një mendim se çka duhet bërë çfarë masash duhet të meren për tu parandaluar dhe të ulet numri i këtyre veprave penale.

Veprat penale kundër jetës dhe trupit të njeriut janë vepra të rënda të parapara me ligj, sepse ato cënojnë të drejtën themelore dhe më të çmuar të njeriut: të drejtën për të jetuar, e cila është një e drejtë e garantuar me kushtetutë dhe e drejtë themelore e secilit individ që ekziston në ruzullin tokësor. Veprat penale kundër jetës dhe trupit të njeriut janë vepra me të cilat personi privohet nga jeta apo i shkaktohet ndonjë lëndim trupor, pasojat nga këto vepra mund të jenë asgjësimi, rrezikimi apo dëmtimi i individit. Me këtë akt shkilet kodi penal, i cili akt ka për pasojë dënimin.

Për veprat penale kundër jetës dhe trupit të njeriut ekziston kodi penal i cili i sanksionon në mënyrë të duhur kryesisht nga lloji i veprës. Në Kodin Penal të RM-së theksohet se ai i cili do ta privojë nga jeta tjetrin, do të dënohet me së paku 5 vjet burgim. Kurse ai i cili tjetërkujt do ti shkaktojë lëndim trupor ose do t'ia keqësojë shëndetin, do të dënohet me gjobë apo me burgim deri në tre vjet.

Faktorët kriminogjen janë të gjitha ato shkaqe, dukuri, rrethana dhe kushte që ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit dhe sjelljeve kriminale në një vend. Pra në kuptimin më të gjërë të fjalës faktorët kriminogjen paraqesin të gjithë faktorët që ndikojnë në formësimin dhe realizimin e sjelljeve të cilat janë të ndëshkueshme me ligj si dukuri shoqërore dhe individuale. Faktorët kriminogjen të cilët kontribuojnë në kriminalitet në përgjithësi ndahen në: Faktorë të jashtëm objektiv apo ekzogjen dhe faktorë të brendshëm subjektiv apo endogjenë. Ku secili prej tyre ka rolin dhe rëndësinë e vet në paraqitjen e sjelljeve kriminale, apo ndonjëherë edhe kombinohen disa nga këto faktorë në paraqitjen e sjelljeve devijante.

Ekzistojnë shumë faktorë të cilët ndikojnë në paraqitjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit, apo e nxisin individin në kryerjen e këtyre veprave penale. Qofshin ato faktorë që kanë të bëjnë me rethanat shoqërore, qofshin ato faktorë që kanë të bëjnë personalisht me natyrën e individit. Nga ndikimi i faktorëve të ndryshëm personi mund të vijë deri në atë gjendje ku vendos të kryej vepër penale, faktorët qofshin ato të jashtëm apo të brendshëm, gjithnjë kanë ndikim tek secili individ, por varësisht se si individ i përballlet dhe i tejkalon ato faktorë apo thënë më qart ato ngacmime që vijnë nga jashtë, ashtu do të paraqitet dhe do të veprojë në shoqëri. Vrasjet ndodhin nga faktorë dhe motive të ndryshme, por në literaturën kriminologjike në përgjithësi më shumë flitet për faktorët e jashtëm si faktorë që kanë ndikim më të madh në kryerjen e veprave penale kundër jetës dhe trupit, por nga hulumtimi i bërë në gjykatën e shkallës së parë në Tetovë erdhëm në përfundim se motivet apo faktorët që e shtyjnë individin të kryej një vepër penale të vrasjes janë personale, varësisht se si individ i percepton situatën që është ngacmuar nga jashtë ashtu edhe do të veprojë, por në të shumtën e rasteve faktor shtytës në kryerjen e veprave penale janë kombinimi i të dy llojeve të faktorëve, shkak janë edhe faktorët e jashtëm edhe faktorët e brendshëm, pra zakonisht ka përzierje të faktorëve në kryerjen e këtyre veprave penale, por pak më shumë ndikojnë faktorët e jashtëm sepse këto faktorë janë më ngacmues për individin paraqesin rethana determinuese të sjelljes kriminale dhe zakonisht vrasjet kryhen edhe si shkak i papunësisë, varfërisë, kushteve jo të mira ekonomike apo edhe si rezultat i asaj se individi rrjedh nga ndonjë familje e degraduar, apo edhe si shkak i alkoolit, narkomanisë etj.

Prandaj duhet të meren masa urgjente nga shteti që me angazhimin e gjithë institucioneve shtetërore, autoriteteve të larta shtetërore dhe organizatave të ndryshme të cilat meren me liritë dhe të drejtat e njeriut të mund të arrihet parandalimi që këto faktorë mos ndikojnë apo thënë më qartë të ndikojnë më pak në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Dhe të arihet parandalimi i kriminalitetit të dhunës në përgjithësi, pasi që me aktivizimin e gjithë institucioneve shtetërore që janë kompetente për këto çështje, autoriteteve dhe organizatave nëse punohet dhe krijohen projekte në këtë drejtim mund të arrihet parandalimi i kriminalitetit, dhe të kemi një botë më të qetë, më të mirë dhe në paqe për të gjithë.

Dhe shpresoj që në të ardhmen asnjë vepër penale kundër jetës dhe trupit të njeriut të mos ngelet pa u dënuar siç është e paraparë me ligj, dhe asnjë krim të mos ngelet pa u zbuluar...



Bibliografia

Hans V.Hentig, Crime causes and conditions, 1959

Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2011

Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2000

<https://www.slideshare.net/dritashala/kriminologjia-18679197>

Ragip Halili, Viktimologjija, Prishtinë, 2007

Ragip Halili, Kriminologjia me Penologji, Prishtinë,1995

Sue Titus Reid, Crime and Criminology, Ninth Edition, 2000

<https://vavav.ru/sq/mental-development/psychology-is-the-temperament-of-a-persons-character-what-is-temperament/>

Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e posaçme, Tetovë 2007

Ismet Elezi, E drejta penale, pjesa e posaçme, Tiranë, 2007

Zejnullah Gruda, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Prishtinë, 2000

Revista Maqedonase për të Drejtën Penale dhe Kriminologjinë, Grup Autorësh, Shkup 1995

http://www.kolegji-juridica.org/new_web/wp-content/uploads/2017/03/Dr.-Vesel-LATIFI-Zbulimi-dhe-të-provuarit-e-vrasjes.pdf

Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Afrim Osmani, teksti integral i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, Botimi i dytë, Shkup, 2015

Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtare e RM nr.150/10)

Ligji për egzekutimin e sanksioneve penale (Gazeta zyrtare e PM nr. 2/06, 57/10)

Sue Titus Reid, Criminal Law, Fourth Edition, 1998

Michael J. Allen, Textbook on Criminal Law, 2003

Jonathan Doak, Victims' Rights, Human Rights and Criminal Justice, 2008

Harlow, Longman, Crime and Criminal Justice policy, second edition

Keir Starmer, Michelle Strange & Quincy Whitaker, Criminal Justice Police Powers & Human Rights, Blackstone's Human Rights Series

<https://www.alsat-m.tv/vrasje-ne-fshatin-rashce-te-sarajit/>

http://time.ikub.al/a908c02d26/42a06c7e44c2cf31f122b5cf12b77733/lajm_Vrasja-me-kallash-per-motive-hakmarrje.aspx

Vesel Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2006

<https://portalb.mk/595239-pthp-eshte-kryer-ekspertize-ne-vendin-ku-ndodhi-vrasja-ne-tetove-vrasesi-eshte-paraqitur-ne-polici/>

Vllado Kambovski, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Shkup 2007

Ismet Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2008

<https://www.google.com/search?q=parandalimi+i+krimet&spell=1&sa=X&ved=0ahUKEwilqIGkq8fjAhUGxIsKHdrjAlgQBQgqKAA&biw=1455&bih=726>

Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2005

<https://www.botasot.info/opinione/596326/vrasjet-ne-kosove-dhe-rol-i-organeve-shteterore-ne-parandalimin-e-vrasjeve/>

<https://sot.com.al/opinione/rritja-e-kriminalitetit-dhe-lufta-ndaj-tij>